

KOMISIONI I KOMUNITETIT EUROPIAN

Bruksel (14.10.2009)
Sek (2009) 1340

DOKUMENT PUNE I STAFIT TË KOMISIONIT

KOMUNIKATËN NGA KOMISIONI EVROPIAN PËR PARLAMENTIN DHE KËSHILLIN EVROPIAN

Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2009 -2010

{Kom 2009 (533)}

Përmbajtja

1. Hyrje	4
1.1. Parathënie	4
1.2. Konteksti	4
<u>1.3</u> Marrëdhëniet e BE-së me Kosovën.....	5
1.4 Kriteret politike	6
2.1. Demokracia dhe Sundimi i ligjit	7
2.2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e pakicave.....	12
2.3 Çështjet Rajonale dhe Obligimet Ndërkombëtare.....	21
3. Kriteret Ekonomike	23
3.1 Ekzistimi i një ekonomie funksionale të orientuar në treg.....	23
3.2 Kapaciteti për të përballuar tensionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda BE-së	29
4. Standardet Evropiane	31
4.1. Tregu i Brendshëm	31
4.1.1 Lëvizja e lirë e mallrave.....	31
4.1.2 Lëvizja e personave, shërbimeve dhe e drejta e themelimit të Kompanive	32
4.1.3 Lëvizja e Lirë e Kapitalit	32
4.1.4 Doganat dhe tatimet	33
4.1.5 Konkurrenca.....	35
4.1.6 Prokurimi Publik.....	36
4.1.7 E drejta e Pronësisë Intelektuale	37
4.1.8 Punësimi dhe Politikat Sociale	38
4.1.9 Arsimi dhe hulumtimet	40
4.2. Politikat sektoriale.....	41
4.2.1 Industria dhe NVM-të.....	41
4.2.2 Bujqësia dhe peshkataria	42
4.2.3 Mjedisi	43
4.2.4 Politika e transportit	44

4.2.5 Energjia	46
4.2.6 Shoqëria informative dhe mediat	48
4.2.7 Kontrolli financiar.....	49
4.2.8 Statistikat	50
4.3. Drejtësia, Liria dhe Siguria	51
4.3.1. Vizat, menaxhimi i kufirit, azili dhe migracioni	51
4.3.2. Shpëlarja e parave.....	52
4.3.3. Narkotikët	53
4.3.4. Policia	54
4.3.5. Luftimi i krimit të organizuar dhe terrorizmit	55
4.3.6. Mbrojtja e të dhënave personale	56

DOKUMENT PUNE I STAFIT TË KOMISIONIT

RAPORTI I PROGRESIT PËR KOSOVËN NËN REZOLUTËN 1244 TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË OKB

1. Hyrje

1.1. Parathënie

Që nga marsi 2002, Komisioni i ka raportuar rregullisht Këshillit dhe Parlamentit rreth progresit të bërë nga ana e shteteve të rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Ky raport në përgjithësi ka strukturën e atyre të viteve të kaluara. Raporti:

- Shkurtimeisht përshkruan raportet mes Kosovës¹ dhe Bashkimit
- Analizon situatën politike në Kosovë në aspektin e demokracisë, sundimit të ligjit, drejtave të njeriut, mbrojtjes së minoriteteve dhe çështjeve rajonale;
- Analizon situatën ekonomike;
- Rishikon kapacitetet e Kosovës në implementimin e standardeve evropiane që është përafrimi gradual i legjislacionit dhe politikave me ato të acquis në vijë me prioritetet e Partneritetin Evropian.

Raporti mbulon periudhën nga tetori 2008 deri në mesin e shtatorit 2009. Përparimi është matur bazuar në vendimet e marra, legjislacionin e aprovuar dhe masat e ndërmarra. Si rregull, legjislacioni dhe masat të cilat janë në përpilim apo në pritje të aprovimit nga ana e Kuvendit nuk janë marrë në konsiderate. Qasja siguron trajtim të barabartë gjatë gjithë raporteve dhe lejon një vlerësim objektiv.

Raporti është bazuar në informatat e grumbulluara dhe të analizuara nga ana e Komisionit. Gjithashtu janë shfrytëzuar burime të tjera duke përfshirë edhe autoritetet e Kosovës, Shtetet Anëtare të BE-së, Përfaqësuesin Special të BE-së në Kosovë, EULEX-in, Raportet e Parlamentit Evropian² dhe informatat nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare dhe joqeveritare.

Komisioni sjell konkluzione të hollësishme për Kosovën në komunikimin e veçantë për zgjerimin³, bazuar në analizat teknike të përfshira në këtë raport.

Paralel me këtë Raport, komisioni ka sjellë edhe Komunikatën “Kosova* – Përmbushja e Perspektivës Evropiane” të Parlamentit Evropian dhe Këshillit.

1.2. Konteksti

Gjatë periudhës raportuese, Sekretari i Përgjithshëm i KB (SPKB) ka përpiluar tri raporte për Kosovën. Raporti i nëntorit 2008, bëri të mundur vendosjen e misionit të EULEX-it

¹ Nën Rezolutën KSKB 1244/199

² Deri në shtator, raportues për Kosovën ishte z. Joost Lagendijk. Që nga shtatori, raportuesja e re është znj. Ulrike Lunacek.

³ Strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore 2009-2010 (COM(2009) 533 të dates 14.10.2009).

* Nën Rezolutën KSKB 1244/199

nën ombrellën e KB. Në mars 2009, SPKB ka theksuar përsheptimin e rikonfigurimit të UNMIK-ut në drejtimin e përshtatjes së funksioneve të veta, bazuar në realitetin e ri të krijuar në terren. Raporti i qershorit 2009 shpreh së funksionet e mbetura të UNMIK-ut, i reduktuar në 10% të kapaciteteve krahasuar me një vit më parë, përmbledhin monitorimin, raportimin dhe lehtësimin, kudo që nevojitet dhe është e mundur, e aranzhimeve ndërkombëtare të Kosovës.

KFOR, prania ushtarake ndërkombëtare në Kosovë e udhëhequr nga NATO, vazhdon të mbetet përgjegjës për sigurinë e përgjithshme. Pas vlerësimit të zhvillimeve, KFOR-i ka filluar planin për reduktim gradual të pranisë në terren.

Në prill, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ka pranuar 36 kërkesa të shkruara duke prezantuar faktet mbi pajtueshmërinë e shpalljes së njëanshme të pavarësisë nga ana e Kosovës me të drejtën ndërkombëtare.

Në qershor, Kosova është bërë anëtare e plotë e FMN dhe BB

Deri më tani, Kosovën e kanë njohur 62 shtete anëtare të KB, përfshirë këtu 22 shtete anëtare të BE-së.

1.3 Marrëdhëniet e BE-së me Kosovën

Kosova merr pjesë në **Procesin e Stabilizimit dhe Asociimit**. Takimet Plenare të Mekanizmit Përcjellës të Procesit të Stabilizimit dhe Asociimit (MPSA) janë mbajtur në dhjetor të vitit 2008 dhe qershor të vitit 2009. Në gjashtëmuorin e parë të vitit 2009, janë mbajtur gjashtë takime MPSA Sektoriale, në sferat e inovacionit, tregut të brendshëm, qeverisjes së mire, ekonomisë, infrastrukturës dhe bujqësisë.

Në dhjetor 2008, EULEX është vendosur anëmbanë territorit të Kosovës, duke marrë përgjegjësi në fushat e policisë, doganave dhe gjyqësisë. Misioni ka arritur kapacitetet e veta të plota në prill. Incidentet e fundit kanë dëmtuar pronën e EULEX. Kosova duhet të sigurojë mbështetjen e vazhdueshme për punën e EULEX.

Në shkurt, Parlamenti Evropian ka nxjerrë një rezolutë përmes së cilës ka shprehur përkushtimin e BE-së për të luajtur rol udhëheqës në sigurimin e stabilitetit të Kosovës dhe Ballkanit Perëndimor si tërësi dhe ka ritheksuar gatishmërinë për mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe politik të Kosovës duke i ofruar perspektive të qartë për anëtarësim në BE. Në prill është mbajtur takimi i dytë ndër-parlamentar BE-Kosovë. Nga ky takim është lëshuar një komunikatë e përbashkët përmes së cilës është theksuar së situata e përgjithshme e stabilitetit politik të Kosovës është e kënaqshme.

Në shkurt, Komisioni ka ripërtërirë mandatin e përfaqësuesit special të BE-së në Kosovë, duke i mundësuar bashkëpunimin e ngushtë me autoritetet e Kosovës. Përfaqësuesi Special i BE-së është njëkohësisht edhe kreu i Organizatës Civile në Kosovë.

Në mars, autoritetet kanë organizuar Takimin e Forumit të Nivelit të Lartë për Koordinimin e Donatorëve si vazhdimësi e Konferencës së Donatorëve të organizuar nga Komisioni Evropian në korrik të vitit 2008.

Autoritetet e Kosovës kanë prezantuar të arriturat dhe sfidat në sektorët kyç të reformës. Donatorët kanë shprehur mbështetjen në vazhdim të agjendës evropiane të Kosovës.

Kosova vazhdon të përfitojë nga Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA), asistenca mikrofinanciare, Asistenca e Komunitetit për Rindërtim, Zhvillimi dhe Stabilitet (CARDS), Instrumenti për stabilitet (IfS) dhe burime të tjera të fondeve. Përafërsisht 500 milion euro i janë dhënë Kosovës ndër vite përmes IPA-së. Dokumenti i Planit Indikativ shumëvjeçar 2009-2011, dokumenti që identifikon fushat kryesore dhe prioritetet e asistencës së IPA-së, është aprovuar në korrik. Mbi 103 milion euro janë ndarë për Programimin Vjetor 2009 të IPA-së. KE ka vazhduar të mbështes forcimin e sundimit të ligjit, reformën e administratës publike, komunitetet, kulturën dhe rininë, çështjet e gjëra socio-ekonomike duke përfshirë tregun dhe zhvillimet rajonale, arsimin dhe punësimin si dhe bujqësinë. Në prill, Qeveria ka emëruar Kryeshefin Ekzekutiv të Agjencisë për Koordinimin e Zhvillimit dhe Integrim Evropian si koordinator të IPA-së

Në drejtim të përmirësimit të pjesëmarrjes së shoqërisë civile në dialogun politik dhe formulim janë ndarë 1.7 milion euro në kuadër të IPA 2008. Fushat si ambienti dhe mundësitë e barabarta (masat kundër diskriminimit dhe përfshirja sociale e grupeve të rrezikuara) kanë pasur trajtim të veçantë. Në kuadër të IPA 2009, 3 milion euro i janë destinuar shoqërisë civile, mbrojtjes së të drejtave të minoriteteve dhe fuqizimit të rrezikuara. Këto çështje janë mbështetur edhe nga Instrumenti Evropian i Demokratizimit dhe të Drejtave të Njeriut.

Si reagim ndaj krizës ekonomike, është krijuar pakoja e krizës së IPA-së, pako e përbërë prej 200 milion eurosh dedikuar Ballkanit Perëndimor, që pritet të mbështesë investimet për së paku 1 miliard euro, bashkë-financuar nga institucionet financiare partnere. Kosova do të përfitojë nga një pjesë e fondeve shumë përfituese të programuara për stimulimin e konkurrencës, stimulimin e NMV-s, efikasitetit energjetik dhe rregullimin e sektorit bankar në Ballkanin Perëndimor. Për më shumë, fondi njëvjeçar i IPA është programuar në drejtim të përmirësimeve të infrastrukturës. Një shumë prej 25 milion eurosh është premtuar për Mbështetjen e Projekteve Infrastrukturore për dy projekte të rrjetit të ujësjellësit/kanalizimit dhe përmirësimit të ngrohjes urbane.

2. Kriteret politike

Ky seksion shqyrton progresin e Kosovës drejt arritjes së kriterëve politike të Kopenhagës, të cilat kërkojnë stabilitet të institucioneve për të garantuar demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut si dhe respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve. Ai po ashtu monitoron bashkëpunimin regjional, marrëdhëniet e mira me vendet në zgjerim si dhe vendet anëtare dhe respektimin e obligimeve ndërkombëtare, siç është bashkëpunimi me Tribunalin Ndërkombëtar për Krime për ish Jugosllavinë.

2.1. Demokracia dhe Sundimi i ligjit

Kushtetuta

Kushtetuta e Kosovës është në përputhje me Standardet Evropiane, të cilat kërkojnë stabilitet institucional duke garantuar demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve. Sigurimi i plotë për respektimin e sundimit të ligjit, të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve janë prioritetet kyçe të Partneritetit Evropian të datës 18 shkurt 2008⁴.

Parlamenti

Plani vjetor i punës së Kuvendit për vitin 2009 është miratuar dhe është në përputhje me strategjinë legjislative të qeverisë. Gjate periudhës raportuese kuvendi ka zhvilluar përgjegjësitë *ex ante* për sa i përket buxhetit. Ka intervenuar për të ruajtur fondet e alokuara për institucionet, si dhe ka rishikuar raportet për shpenzimet e tyre *ex post*.

Ndërveprimi në mes kuvendit dhe shoqërisë civile është përmirësuar. Kuvendi ka emëruar Ombudsmanin në qershor 2009. Megjithatë dialogu në mes kuvendit dhe shoqërisë civile nuk është zhvilluar sa duhet.

Kuvendi ka miratuar rezolutën mbi prioritetet e Kosovës dhe strategjitë për integrim evropian. Plani i Veprimit i kuvendit është aprovuar në shkurt. Ai siguron udhëheqje dhe ju ndan detyra të gjitha komiteteve të kuvendit për të mbikëqyrur qeverinë në implementimin e Prioriteteve të Partneritetit Evropian. Komitetit i kuvendit për integrim evropian është i ngarkuar për të monitoruar implementimin efektiv të planit të veprimit. Kapacitetet administrative dhe financiare të komiteti duhet forcuar. Bashkëpunimi i këtij komiteti me Agjencinë për Koordinim të Zhvillimit dhe Integritit Evropian duhet zhvilluar ende. Komitetet e kuvendit duhen përmirësuar kapacitete e tyre administrative dhe shkathtësitë teknike për të përcjellë me kujdes legjislacionin. Mbikëqyrja parlamentare mbi degët ekzekutive duhet përmirësuar.

Është aprovuar plani i punës për vitin 2009 i Komitetit Qendror Zgjedhor. Në maj është emëruar kryeshefi ekzekutiv i Sekretariatit. Është themeluar Zyra për Regjistrimin e Partive Politike por ajo ende nuk është funksionalizuar. Komisioni ende vazhdon të mbështetet në përkrahjen e OSBE-s. Kapacitetet i ka të dobëta si dhe largimi i stafit është i madh.

Në përgjithësi kuvendi ka shënuar progres në një numër fushash, veçanërisht sa i përket renditjes së procedurave të punës. Duhet përforcuar kapacitetet për të shqyrtuar draft legjislacionin dhe për të monitoruar implementimin pas miratimit. Mbikëqyrja parlamentare e qeverisë duhet të rritet.

Qeveria

⁴ Vendim i Këshillit 2008/213 KE

Strukturat kryesore të qeverisë janë themeluar dhe funksionojnë në përputhje me dispozitat kushtetuese relevante. Shumica e pozitave të larta janë plotësuar me emërimin e zëvendësministrave Tregti, Punë të Jashtme dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Stabiliteti politik është mbajtur. Qeveria ka konsoliduar kapacitetet e saj duke themeluar Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Këshillin e Sigurisë së Kosovës si dhe Agjencinë e Inteligjencës së Kosovës.. Megjithatë mbikëqyrja demokratike e sektorit të sigurisë së Kosovës duhet forcuar më tej.

Në janar qeveria ka paraqitur para kuvendit raportin e saj vjetor. Janë adoptuar ligji mbi Shërbimin e Jashtëm si dhe ligji mbi Shërbimet Konsullore të Misioneve Diplomatike dhe Konsullore. Në maj qeveria ka organizuar forumin e nivelit të lartë në marrjen e shënimeve mbi progresin e bërë që nga Konferenca e Donatorëve për Kosovën nga qershori 2008, si dhe në informimin e donatorëve mbi implementimin e reformave.

Qeveria ka vazhduar në ndërtimin e kapaciteteve për përafrim me BE-në dhe për forcimin e AKZHIE-s. Plani i Rishikuar i Veprimit për Partneritet Evropian është adoptuar në gusht. Ky është një hap i rëndësishëm, mirëpo prioritetizimi i mëtejshëm është i nevojshëm. Qeveria tash duhet të fokusohet në implementimin e tij. Agjencia ka nevojë të marrë rol më të madh në këtë drejtim. Drejtori i ri është emëruar dhe struktura e punës është përmirësuar. Grevat e janarit nga punonjësit e Agjencisë tashmë janë zgjidhur. Megjithatë, Agjencia ka nevojë për udhëheqje politike nga këshilli ministror për integrim evropian. Rezultatet e qeverisë për përkushtim ndaj integriteteve evropiane duhet përmirësuar. AKZHIE në këtë aspekt duhet të marrë rol qendror, me përkrahje të lartë politike për të zhvilluar mandatin e saj.

Ka pasur ca progres në fushën e reformës së administratës për qeverisje lokale dhe decentralizim, që është prioritet kyç i Partneritetit Evropian. Janë emëruar grupet punuese për reformën legjislative, themelimin e komunave të reja, dhe delegimin e kompetencave dhe burimeve, kampanjave informative, koordinim të donatorëve dhe ndërtim kapaciteteve. MALG-ja ka miratuar strategjinë afatmesme 2009-2012. Zgjedhjet lokale janë caktuar për 15 nëntor. Kosova duhet të sigurojë që ato të zhvillohen në përputhje me standardet ndërkombëtare. Sfidë e veçantë do të jetë sigurimi që të gjitha komunitetet të marrin pjesë në zgjedhje.

Megjithatë, koordinimi dhe ndërveprimi ndërministror mbetet i dobët. Ligji mbi Qeverinë nuk është miratuar. Roli qendror për drejtim politik i këshillit ministror nuk implementohet në tërësi. Kapaciteti i qeverisë lokale mbetet i dobët. Ligji mbi qytetin e Prishtinës ende nuk është aprovuar. Ende mungon mekanizmi efektiv për të monitoruar dhe vlerësuar kualitetin e shërbimeve nga komunat.

Situata e sigurisë në veri mbetet shqetësuese. Qeveria duhet forcuar përpjekjet e saj në këtë drejtim. Duhet përpjekje shtesë për të adresuar ngurrimin e serbëve të Kosovës për të marrë pjesë aktive në institucionet e Kosovës, përfshirë zgjedhjet lokale që janë në pritje.

Ka pasur ndërhyrje politike në emërime të zyrtare në pozitat kyçe të shërbimit civil (përfshirë pozita të larta brenda ministrive, bordeve të ndërmarrjeve publike, zyrës së Ombudsmanit, Gjykatës Kushtetuese). Kjo ka dëmtuar kredibilitetin e institucioneve të Kosovës për të menaxhuar procesin e emërimeve në mënyre të drejte dhe transparente.

Në përgjithësi strukturat e qeverisë të themeluara rishtazi funksionojnë dhe stabiliteti politik është ruajtur. Progres i limituar është arritur sa i përket adoptimit të legjislacionit dhe ndërtimit të kapaciteteve. Ka pasur progres në reformën e qeverisë lokale. Implementimi efektiv i decentralizimit në të mire të të gjitha komuniteteve mbetet sfida kryesore. Koordinimi ndërministror ka nevojë për forcim të mëtutjeshëm. Ndërhyrjet politike në emërime të larta mbeten çështje shqetësuese.

Administrata Publike

Rishikimi i detyrave dhe përgjegjësi brenda administratës publike (rishikimi funksional) është përfunduar si dhe shumica e rekomandimeve janë implementuar. Rishikime të veçanta janë kryer për Ministrinë e Shërbimeve Publike⁵ Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrinë Punëve të Brendshme si dhe për Shërbimin Kadastral të Kosovës. Gjashte grupe punuese janë themeluar për të mbikëqyrur procesin e reformës së administratës. Ato raportojnë në komitetin ndërministror të kryesuar nga zëvendëskryeministri.

Gjatë periudhës raportuese, Bordi i Pavarur Mbikëqyrës ka zgjidhur 166 ankesa të punonjësve të administratës publike. Bordi është një organ i pavarur i cili i raporton drejtpërsëdrejti Kuvendit të Kosovës. Dy të emëruarit e fundit nga tetë anëtarët sa ka Bordi janë emëruar në korrik nga Kuvendi.

Megjithatë, legjislacioni që ndërlidhet me reformën e administratës publike mbetet për t'u miratuar, me saktësisht ligjet mbi shërbimin civil, mbi pagat si dhe mbi organizimin e institucioneve të administratës publike. Këto ligje janë esenciale në sigurimin e respektimit të pavarësisë së shërbimit civil. Nevojitet një dallim i qartë ndërmjet shërbyesve civilë dhe stafit politik. Komisioni për Emërime të Larta Publike ende nuk është plotësisht funksional. Kjo ka penguar procesin e rekrutimeve për pozita të larta nëpër ministri. Kapacitetet administrative të Sekretariatit të Komisionit mbeten të kufizuara.

Zyra e Ombudsmanit duhet fuqizuar edhe më tej.

Trajnimi dhe certifikimi i shërbyesve civilë vazhdon të ofrohet nga IKAP-i. Megjithatë, Instituti ka kapacitete dhe burime të limituara gjë që ndikon në kualitetin dhe sasinë e trajnimeve të ofruara. Ai duhet integruar më mirë në aktivitetet e Shkollës Rajonale për Administratë Publike. Ka nevojë për përpjekje shtesë për të forcuar kapacitetet e institucioneve të ngarkuara me reformë të administratës publike, si dhe për të lejuar transferimin e dijeve dhe përvojave më të mira në regjion.

⁵ Në maj, Ministria e Shërbimeve Publike është emëruar në Ministri të Administratës Publike

Në përgjithësi, ka pasur ca progres për sa i përket reformës së administratës publike me kompletimin dhe vazhdimin e rishikimit funksional. Aktet kyçe ligjore duhet miratuar. Sigurimi i shërbimeve të administratës publike për të gjithë njerëzit e Kosovës si dhe vendosja e një administrate publike profesionale, llogaridhënëse, të qasshme e përfaqësuese pa ndikime politike është prioritet kyç i Partneritetit Evropian. Kjo nuk është garantuar plotësisht. Kapacitetet e administratës publike të Kosovës mbesin të dobëta. Nevojiten përpjekje substanciale për të siguruar transparencë për emërimet publike.

Sistemi Gjyqësor

Ligji mbi Gjykatën Kushtetuese është miratuar. Gjashtë gjyqtarët kosovarë, përfshirë dy përfaqësues nga komunitetet, janë emëruar në maj nga kuvendi i Kosovës dhe janë aprovuar në qershor nga Presidenti i Kosovës. Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar po ashtu ka emëruar tre gjyqtarë në qershor. Megjithatë, Kosova ende duhet të miratojë pakon e katër ligjeve reformuese: mbi Gjykatat, mbi Këshillin Gjyqësor të Kosovës, mbi Prokurorinë dhe Këshillin Prokurorial.

Ministria e Drejtësisë ka përfituar përgjegjësi të reja në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar. Që nga maji, departamenti i saj për çështje ligjore ka shqyrtuar kërkesa nga vendet tjera, siç janë ekstradimet, zbatimi i vendimeve të gjykatës, transferimin e të dhënave kriminale etj. UNMIK-u mbetet përgjegjës për bashkëpunim gjyqësor ndërkombëtar me vendet të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, përfshirë kërkesat që vijnë nga Serbia. Ajo vazhdon të mbetet pikë kontakti me Interpolin. Nevojiten miratimi i procedurave të qarta për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar dhe duhet të respektohen në vazhdimësi nga gjykatat dhe prokurorët. Kapaciteti administrativ i ministrisë mbetet i dobët. Departamenti i tij ligjor duhet forcuar.

Gjatë periudhës raportuese, Kosova ka miratuar një numër të rëndësishëm ligjesh që ndërlidhën me gjyqësorin: Ligji mbi Noterinë, Ligji mbi Procedurën Kontestuese (Ligji për Procedurë Civile), Ligji mbi Provimin e Judikaturës, Ligji mbi Ndërmjetësimin, Ligji mbi Plotësimin dhe Ndryshimin e Kodit Kosovar mbi Procedurën Penale. Ligji mbi Përbërjen e Përkohshme të Këshillit Gjyqësor është aprovuar në dhjetor. Anëtarët e Këshillit janë emëruar në korrik, Këshilli tashmë është funksional. Megjithatë, ligji përmban dispozita të cilat nuk janë në vijë me standardet evropiane. Implementimi i tyre ka penguar aktivitetet e këshillit, duke ndikuar në vazhdimësinë e menaxhimit të gjykatave si dhe zhvillimin e hetimeve disiplinore ndaj gjyqtarëve.

Akuzat për korrupsion dhe keqpërdorime në gjykata nuk janë hetuar si duhet. Zyra për Masa Disiplinore përgjegjëse për këto aktivitete nuk është plotësisht funksionale. Njësia e Auditimit në Gjyqësi ka lëshuar rekomandime për sa i përket funksionimit të gjykatave të cilat nuk janë marrë parasysh sa duhet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Procesi i verifikimit dhe riemërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Kosovë tashmë ka filluar nën mbikëqyrjen e Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial. Megjithatë, hezitimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve nga komuniteti serb për t'u përfshirë në këtë proces mbetet

shqetësues. Komiteti për provimin e jurisprudencës nuk është funksional, gjë që ka ngushtuar pjesëmarrjen në proces.

Gjykatat nëpër tërë Kosovën janë pajisur me kompjuterë, që ka mundësuar instalimin e softuerit për sistemin e menaxhimit të informacionit dhe regjistrimin në sistem të të dhënave nga librat e vjetër për regjistrim. Sistemi është operacional nëpër të gjitha gjykatat e Kosovës dhe trajnimi për përdorimin e tij është duke vazhduar.

Gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it janë dërguar në mision. Është miratuar Ligji për Juridiksionin dhe ndarjen e rasteve për gjyqtarë dhe prokurorë të EULEX-it. EULEX ka marrë 100 vendime gjyqësore dhe ka shpallur 27 gjykime kryesisht për raste penale. Misioni gjithashtu ka filluar një hetim për akuzat për trafikim organesh.

Ka pasur shume greva në sektorin e drejtësisë. Kjo ka rezultuar në vonesat e mëtejme të gjykimeve. Nuk ka pasur përmirësime të dukshme në reduktimin e numrit të rasteve të pazgjdhura për rastet civile dhe penale përfshire ato nga Gjykata Supreme. Dhoma Speciale e Gjykatës Supreme, përgjegjëse për rastet që lidhen me privatizimin, është paralizuar për shkak të mungesës së gjyqtarëve lokalë. Kjo është një çështje me shqetësim të veçantë. Bashkëpunimi në mes të zyrës së prokurorit dhe policisë është i kufizuar.

Nuk ka pasur progres në marrjen me rastet e ngjarjeve të marsit 2004. Trajtimi i rasteve penale në këtë kontekst vazhdon të jetë i komplikuar nga një numër çështjesh sikur që është zhdukja e dëshmitave dhe deklaratave të dëshmitareve, zhvendosja e njerëzve, refuzimi i disa nga policëve të Policisë së Kosovës të bashkëpunojnë, sikurse edhe kërcënimi i dëshmitareve, gjykatësve dhe prokurorëve. Gjykata në Mitrovicën veriore përbehet nga gjykatës dhe prokurorë të EULEX-it dhe punon me kapacitet të kufizuar. Sundimi i ligjit në Kosovën veriore nuk është i garantuar. Si autoritetet kosovare ashtu edhe ato serbe duhet të bëjnë përpjekje në këtë aspekt.

Në tërësi Kosova është në një fazë të hershme në adresimin e prioriteteve në fushën e drejtësisë. Sistemi i drejtësisë mbetet i dobët, i cenueshëm nga intervenimi politik dhe joefikas. Ka një numër të madh të rasteve të pazgjdhura. Problemet strukturore të shërbimeve të prokurorive të Kosovës duhet të adresohen. KGJK nuk funksionon me efikasitet. Gjyqësori i Kosovës është ende në nevojë të reformave të mëdha dhe qeveria duhet të sigurojë pjesëmarrjen e komunitetit serb të Kosovës në këtë proces. Serbët e Kosovës gjithashtu duhet të marrin hapa proaktivë dhe konstruktivë në lidhje me këtë. Sigurimi i respektimit të plotë të sundimit të ligjit është prioritet kyç i partneritetit evropian.

Politikat kundër-korrupsionit

Kosova ka shënuar progres të kufizuar në luftimin e korrupsionit. AKK është plotësisht operacionale dhe me staf të plotë. Agjencia ka nënshkruar një numër të marrëveshjeve të mirëkuptimit me institucionet e tjera relevante, siç janë Komisioni i Pavarur Prokurorial dhe Gjyqësor (për lejimin e shkëmbimit të informatave mbi korrupsionin në sistemin

gjqësor), me Qendrën e Inteligjencës Financiare, me Kreun e Prokurorëve të EULEX-it dhe me Ombudspersonin.

Sidoqoftë, korniza ligjore për adresimin e korrupsionit duhet të përmirësohet urgjentisht. Kosova ende duhet të miratojë Ligjin mbi Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurisë dhe ndryshimet e Ligjit Anti-Korrupsion dhe ato të Ligjit mbi Konfliktin e Interesave. Strategjia anti-korrupsion dhe Plani i Veprimit ende nuk janë miratuar. Deri më tani, nuk ka ligj mbi financimin e partive politike. Fuqia e mekanizmave mbikëqyrës dhe mungesa e transparencës në lidhje me financimin e partive politike mbetin çështje me shqetësim serioz. Korniza institucionale mbetet e fragmentuar. Ekziston mungesë e bashkëpunimit në mes akterëve relevantë, sidomos në mes të Agjencisë dhe zyrës së prokurorit. Grupi punues ndërministror për anti-korrupsion ka dështuar në dhënien e rezultateve të prekshme.

Në tërësi, ka pasur progres të kufizuar në luftën kundër korrupsionit, që është prioritet kyç i partneritetit evropian. Korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha në Kosovë dhe vazhdon të jetë një shqetësim shumë serioz. Korniza ligjore dhe institucionale duhet të fuqizohen. Bashkëpunimi në mes Agjencisë dhe zyrës së prokurorit duhet të përmirësohet. Kosova duhet të zhvillojë një regjistër të hetimeve, dënimeve, ndjekjeve penale në rastet anti-korrupsion.

2.2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e pakicave

Respektimi i të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

Bashkëpunimi i Kosovës me mekanizmat e të drejtave të njeriut është i kufizuar pasi që Kosova nuk është pjesëtare e OKB ose e Këshillit të Evropës. Si pasojë, qytetarët e Kosovës nuk e kanë mundësinë e padisë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut ndaj institucioneve të Kosovës. Sa i përket promovimit të forcimit të të drejtave të njeriut, në dhjetor 2008 qeveria ka aprovuar strategjinë dhe planin e veprimit për të drejtat e njeriut për periudhën 2009-2010.

Sidoqoftë, mekanizmat për implementimin e tyre ende nuk ekzistojnë. Disa njësi komunale për të drejta të njeriut nuk janë funksionale, sidomos në komunat me shumicë serbe, që refuzojnë të bashkëpunojnë me nivelin qendror. Ombudspersoni ka një mbikëqyrje të kufizuar sa i përket strukturave paralele serbe. Njësitë për të drejtat e njeriut në nivelin qendror (p.sh. MD, MAP) të mandatuara për implementimin e rekomandimeve të Ombudspersonit nuk janë plotësisht operacionale.

Në tërësi, ka pasur pak progres në këtë fushë, sidomos në miratimin e strategjisë për të drejtat e njeriut dhe planit të veprimit. Sidoqoftë, korniza institucionale për respektimin e normave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në Kosovë duhet të forcohet në mënyrë domethënëse. Sigurimi i respektit të plotë për të drejtat e njeriut është prioritet kyç në partneritetin evropian.

Të drejtat civile dhe politike

Sa i përket **parandalimit të torturës dhe keqtrajtimit dhe luftës kundër mosndëshkimit**, përgjigja e Kosovës ndaj raportit të 2007-ës së Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor apo Degradues apo Ndëshkimit është bërë publik në janar. Rekomandimet e këtij raporti janë marrë në konsideratë nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës.

Hetimet e shkeljeve serioze, përfshirë ato në qendrat e paraburgimit të policisë vazhdojnë të kryhen nga Inspektorati i Policisë së Kosovës. Ky Inspektorat është i pavarur dhe i raporton Ministrin të Punëve të Brendshme. Hetimi i rasteve më të lehta kryhet nga Njësi të Standarde Profesionale të Policisë.

MD është duke ndërmarrë masa për adresimin e ankesave për shkelje në burgje dhe qendra të paraburgimit. Divizioni për avokim dhe asistencë në Ministri vazhdon të ofrojë asistencë viktimave të dhunës familjare dhe atyre të trafikimit. Mosndëshkimi (impunity) mbetet ende çështje brengosëse. Për shume shkelje, autoritetet ende duhet të identifikojnë kryerësit e veprave dhe t'i sjellin ata para drejtësisë si dhe t'i mbrojnë dhe t'i kompensojnë viktimat.

Në tërësi, ka pasur pak progres në adresimin e torturës dhe keqtrajtimit. Lufta kundër mosndëshkimit mbetet një çështje e rëndësishme për pajtim në mes të komuniteteve.

Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore (Forenzikë), ka vazhduar të zhvillojë kapacitetin e saj me mbështetjen e EULEX-it. Gjatë periudhës raportuese, ajo ka zhvilluar 41 operacione në terren (26 zhvarrosje që kanë rezultuar në nxjerrjen e 23 trupave dhe në vlerësimin e 15 vendvarrimeve të tjera të mundshme). Zyra ka intensifikuar punën duke dërguar rreth 200 mostra të eshtrave për analizë të ADN-së. Mbetjet e 40 viktimave u janë kthyer familjeve të tyre. Grupi Punues për personat e pagjetur, që përbehet nga delegacionet e Beogradit dhe Prishtinës, dhe i kryesuar nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, vazhdon të takohet rregullisht. Komiteti ka konsultuar 20 vende, kontingjentet e të cilave ishin dërguar në Kosovë më 1999, në mënyrë që të grumbullojnë dokumentacion për rastet e pazgjidhura. Në fillim të vitit 2009, Komisioni qeveritar për personat e pagjetur themeloi një sekretariat, që gradualisht po bëhet operacional.

Në përgjithësi, progresi në lidhje me të pagjeturit mbetet i ngadalshëm 10 vjet pas numrit më të madh të zhdukjeve: më pak se 40 raste janë mbyllur që nga raporti i fundit i Komisionit Evropian, duke lënë numrin e të pagjeturve në mbi 1800. Mungesa e informacioneve rreth vendeve të pidentifikuara po ndalon progresin e mëtejshëm. Nuk ka ligj mbi mjekësinë ligjore dhe nuk ka departament të mjekësisë ligjore. Nuk ka ligj për personat e zhdukur. Çështja e kompensimit të familjeve të personave të pagjetur duhet të zgjidhet.

Në fushën e **qasjes në drejtësi**, Zyra e Koordinatorit të Ndihmës Juridike ka rritur shtrirjen e vet duke vënë në funksion një uebfaqe dhe një bazë të të dhënave. Në mes të tetorit dhe korrikut 2009 mbi 1400 persona kanë përfituar nga ndihma juridike falas. Zyra

ka nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi me Odën e Avokatëve për arritur efektin e përfaqësimit juridik falas dhe për përmirësimin e shtrirjes tek qytetarët.

Sidoqoftë, resurset e Zyrës së Koordinatorit të Ndhmës Juridike janë të kufizuara dhe numri i stafit është i ultë. Numri më i madh i ankesave tek Ombudspersoni në mes të korrikut 2008 dhe qershorit 2009 ndërlidhen me qasjen në gjykata. Qasja në drejtësi për komunitetet jo-shumicë, sidomos në Kosovën veriore, nuk është e garantuar. Mungesa e një gjyqësori funksional në veri seriozisht e kufizon qasjen në drejtësi për të gjitha komunitetet. Nuk ka përfaqësues serb në zyrën e qarkut për ndihmë juridike në jug të Mitrovicës.

Në tërësi, Zyra për Ndhmë Ligjore ka përmirësuar aktivitetet e saj të shtrirjes dhe bashkëpunimit me Odën e Avokatëve, por duhet ende progres i mëtejshëm për të përmirësuar qasjen në drejtësi në Kosovë.

Sa i përket **sistemit të burgjeve**, shërbimi korrektues i Kosovës nën Ministrinë e Drejtësisë është funksional, përderisa EULEX-it i mbeten disa kompetenca. Masat e sigurisë janë përmirësuar në burgjet e sigurisë së lartë sikurse edhe mjetet teknike, përfshirë veturat për përcjelljen e të burgosurve.

Sidoqoftë, Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale duhet të ndryshohet në linjë me standardet evropiane. Nuk ka ende institucione adekuate për mbajtjen e shkelësve me të meta mendore si dhe të atyre me kapacitet të zvogëluar mendor. Nuk ka hapësirë të ndarë në burgun e Lipjanit për të arrestuarit femra të mitura. Ri-integrimi i të miturve pas lirit është çështje brengosëse. Lehtësimi i transferimit të të burgosurve nga vendet tjera duhet të përmirësohet. Kosova duhet të ndërmarrë hapa për të akomoduar një rritje të numrit të të burgosurve të kthyer.

Shumica e të burgosurve serbë të Kosovës gjenden në qendrën e burgimit në Mitrovicë, që nuk është e pajisur për burgim afatgjatë. Mbështetja nga Prishtina është e kufizuar. Shumica e të burgosurve janë të burgosur në pritje të gjykimit.

Roli i shërbimit sprovues ende nuk është kuptuar sa duhet. Ligji parasheh që prokurorët mund të dërgojnë shkelësit e mitur drejtpërdrejtë tek shërbimi sprovues duke anashkaluar gjykatat. Mekanizmi i përdorimit të dënimeve alternative është i dobësuar nga mungesa e përgjithshme e mbështetjes dhe vetëdijesimit brenda sistemit gjyqësor. Nëse themelohet në mënyrë të duhur, kjo do të reduktonte numrin e madh të rasteve të pazgjdhura. Ndërveprimi i shërbimit sprovues me policinë dhe akterët tjerë duhet të strukturohet më mirë. Ka nevojë për iniciativa më konkrete për promovimin e ri-integrimit social dhe ekonomik të përfituesve të shërbimit sprovues.

Në tërësi, pak progres është shënuar në lidhje me hapësirat korrektuese, por mbetin sfida serioze.

Sa i përket **lirisë së shprehjes**, pavarësia dhe paanshmëria e RTK-së nuk janë siguruar plotësisht. Tri vjet pas hyrjes në fuqi, Ligji që themelon RTK-në ende nuk po

implementohet në mënyrë adekuate. Një anëtar i qeverisë merr pjesë në Komitetin e Kuvendit që është përgjegjës për përzgjedhjen e Bordit të RTK-së, që ende nuk është emëruar. Kjo nuk është në pajtim me rregulloren e punës së Kuvendit. Ka pasur një numër të debateve publike me pjesëmarrjen e Këshillit të Shtypit dhe të Asociacionit të Gazetarëve Profesionistë të Kosovës mbi rastet e ndërhyrjes politike në punën e medieeve. Ligji për Qasjen në Dokumentet Zyrtarë ende nuk po implementohet plotësisht.

Në tërësi, liria e shprehjes nuk është e garantuar plotësisht. Korniza relevante institucionale nuk është funksionale. Rastet e kërcënimit politik kërkojnë masa më të shpejta të autoriteteve kosovare.

Liria e mbledhjes (tubimit) është e garantuar me Kushtetutë. Ligji mbi Organizatat Jo-qeveritare është miratuar në shkurt. Ligji për Tubimet Publike është miratuar në dhjetor 2008. Shoqëria civile vazhdon të varet kryesisht nga financimi ndërkombëtar, gjë që shpie në agjenda të bazuara në projekte dhe të udhëhequra nga donatorët me qëndrueshmëri dhe me pozicionim strategjik afatgjatë të kufizuar. Kapaciteti monitorues i OJQ-ve është i kufizuar dhe pjesëmarrja e tyre në procesin e hartimit të legjislacionit e dobët.

Në tërësi, shoqëria civile është zhvilluar më tej, por ambienti në të cilin operon duhet të përmirësohet dukshëm.

Në lidhje me **lirinë fetare**, Ligji për Pushime njih pushimet ortodokse, islame dhe katolike. Rindërtimi i tanishëm dhe transferi i vendeve ortodokse nën kompetencë të Komisionit Implementues për Rindërtim është një zhvillim pozitiv. Sidoqoftë, ekziston një dialog i kufizuar në mes të komuniteteve të ndryshme religjioze. Shqetësimet për sigurinë bëjnë që pelegrinët shpesh kërkojnë përcjellje nga forcat e sigurisë për në varreza dhe vendet religjioze në lokacionet e banuara me minoritete. Kjo kornizë ligjore për veprimtaritë religjioze është joadekuate pasi që komunitetet religjioze duhet të regjistrohen si OJQ për të marrë identitet legal.

Në tërësi, ka pak progres sa i përket rindërtimit të vendeve religjioze por mbetet shumë për t'u bërë për ripajtimin dhe integrimin e komuniteteve religjioze. Sigurimi i respektit të plotë për lirinë e religjionit është prioritet kyç i partneritetit evropian.

Të drejtat ekonomike dhe sociale

Në fushën e të **drejtave të grave**, Agjencia për Barazi Gjinore vazhdon të monitorojë dhe ndihmojë në implementimin e Programit Kornizë për Barazi Gjinore 2008-2013 në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore. Agjencia ka ngritur kapacitetin e saj. Përqindja e femrave në pozita vendimmarrëse në administratën publike ka shënuar një rritje të vogël deri pak mbi 20%. Ministritë kanë zhvilluar indikatorë për matjen e performancës së politikave dhe programeve për barazi gjinore.

Sidoqoftë, zyrtarët për barazi gjinore nuk janë emëruar në të gjitha ministritë dhe komitetet për barazi gjinore janë themeluar vetëm në dy nga 30 komuna. Përfaqësimi i

barabartë mbetet një sfidë në të gjitha nivelet, sidomos në komunitetet minoritare. Asnjë nga pozitat e larta jo-shqiptare nuk mbahen nga femrat.

Themelimi i njëjësive për dhunën familjare dhe trajnimi i zyrtarëve për t'u ofruar ndihmë viktimave është një hap pozitiv në përpjekjet e policisë për adresimin e dhunës në familje. Sidoqoftë, niveli i dhunës në familje mbetet i lartë. Shumë raste nuk raportohen. Pak raste të dhunës në familje shkojnë në gjykatë. Pjesa më e madhe e viktimave të trafikuar janë femra. 6 strehimoret janë joadekuate dhe nuk ofrojnë nivel të duhur të sigurisë. Vonesat në lëshimin e urdhrave mbrojtës mbesin çështje për shqetësim.

Në tërësi, korniza institucionale për mbrojtjen e të drejtave të grave është forcuar, por dhuna në familje mbetet e përhapur dhe është një çështje shqetësuese. Mbrojtja e grave ndaj të gjitha formave të dhunës duhet të fuqizohet në mënyrë domethënëse.

Të drejtat e fëmijëve janë të përfshira në Strategjinë për të Drejtat e Njeriut 2009-2011. Strategjia për të Drejtat e Fëmijëve dhe plani i veprimit janë miratuar në qershor. ZQM ka emëruar zyrtarin për të drejtat e fëmijëve. Plan i Veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2009-2011 inkorporon të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara në seksionet e arsimit, mbrojtjes së fëmijëve dhe shëndetësi. Ministria e Drejtësisë ka bërë prioritet reformën e sistemit të drejtësisë për të mitur.

Sidoqoftë, nuk ka ende mbrojtje ligjore për fëmijët me aftësi të kufizuara. Vetëm 10% e fëmijëve me nevoja të veçanta vijnë në arsimin fillor. Më përgjithësisht, lënia e shkollës mbetet në shkallë të lartë sidomos në shkollat e mesme (17% për djemtë dhe 9% për vajzat). Trafikimi i fëmijëve dhe puna e fëmijëve mbesin një çështje për shqetësim. Përpjekjet për të adresuar këto fenomene duhet të rriten në bashkëpunim me organizatat relevante dhe në koordinim me përpjekjet në fushat tjera, siç janë arsimi dhe mirëqenia sociale. Qasja e fëmijëve në drejtësi ende nuk është e sigurt. Mungesa e koordinimit në mes të strukturave lokale dhe atyre qendrore ndalon implementimin e Kodit të Drejtësisë për të Mitur.

Në tërësi, mbrojtja e fëmijëve mbetet e dobët. Përpjekje të mëtejme janë të nevojshme për të garantuar të drejtat e fëmijëve.

Në fushën e **rasteve sociale** dhe **personave me aftësi të kufizuara**, Plan i Veprimit është aprovuar në prill. Në dhjetor, qeveria ka miratuar vendimin për riaktivizimin dhe riorganizimin e Këshillit për Persona me Aftësi të Kufizuara.

Sidoqoftë, të dhënat statistikore për personat me aftësi të kufizuara nuk ekzistojnë. Qasja në objektet e arsimit për personat me aftësi të kufizuara mbetet e vështirë. Mungesa e legjislacionit për shëndet mendor pengon trajtimin e pacientëve. Mungesa e shërbimeve adekuate shëndetësore mbetet për t'u adresuar. Analfabetizmi në mesin e njerëzve me aftësi të kufizuara mbetet i lartë.

Në përgjithësi, integrimi dhe mbrojtja e grupeve të cënueshme sociale, në veçanti fëmijëve të braktisur, të kthyerve dhe personave me aftësi duhet të rritet.

Në fushën e të **drejtës për punë dhe sindikata**, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka filluar një bashkëpunim konstruktiv me partnerët ndërkombëtarë për adresimin e një numri të sfidave që ekzistojnë në këtë sektor. Ajo merr pjesë në Programin e Zhvillimit të Punësimit të Qëndrueshëm dhe përfiton nga ekspertiza e ofruar nga projektet e asistencës teknike nga BE.

Në tërësi, legjislacioni për punën implementohet në mënyrë të dobët dhe sindikatat nuk janë sa duhet aktive në dialogun social.

Dispozitat **kundër diskriminimit** janë përfshirë në Strategjinë dhe Planin e Punës për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2009-2011. Qasja e barabartë në strehim, punësim dhe sigurim social nuk respektohet gjithmonë. Vetëdija për çështjet që lidhen me homoseksualët, biseksualët dhe çështjet trans-gjinore është shumë e ultë dhe rastet e dhunës shpesh nuk raportohen. Kërkohen më shumë fushata vetëdijesimi për ta luftuar diskriminimin. Nevojiten më shumë përpjekje për jetësimin efikas dhe monitorimin e Ligjit Kundër Diskriminimit.

Në përgjithësi, diskriminimi mbetet çështje brengosëse. Krijimi i një shoqërie pa diskriminim të çfarëdo lloji dhe promovimi i integritit të grupeve të cenuara është prioritet kyç i Partneritetit Evropian.

Sa i përket të **drejtave pronësore**, Ligji për Eksproprijimin e Pasurisë së Paluajtshme është publikuar në prill. Ky ligj përcakton rregullat dhe kushtet e eksproprijimit në nivel qendror dhe atë lokal. Projektligji mbi Shitjen e Banesave ku të Drejtat e Mbajtjes (së objektit banesor) është rishikuar në mënyrë që të rregullojë privatizimin e banesave në pronësi shoqërore.

Në Korrik, Agjencia Kosovare e Pronës nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi me Agjencinë Kadastrale të Kosovës, për qasje në bazën e të dhënave të kësaj të fundit. Në gusht, Agjencia Kosovare e Pronës gjithashtu nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi me UNHCR-në që t'u mundësohet vazhdimi i aktiviteteve në Serbi. Me shume së 40,000 kërkesa janë regjistruar; gjysma prej tyre janë vendosur/gjykuar nga Komisioni për Kërkesa Pronësore Banësore. Që nga shtatori 2009, 6,700 vendime janë zbatuar, nga të cilat, 770 kanë çuar te riposedimi fizik.

Tre anëtarë ndërkombëtarë të Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë Kosovare të Pronës janë zgjedhur. Dy anëtarë vendorë duhen ende të emërohen. Dy gjyqtarë ndërkombëtarë janë zgjedhur në Gjykatën Supreme, në panelin e ankesave kundër vendimeve të kontestuara nga Agjencia. Gjyqtarët vendorë duhet ende të zgjedhën dhe kjo e paralizon punën e panelit. Agjencia ka finalizuar skemën për kompensim për objektet banësore në pronësi shoqërore, të cilat duhet të aprovohen nga Bordi Mbikëqyrës.

Me tepër së 900 prona janë nën urdhrin për lirimin/lëshimin e pronave. Implementimi i urdhërësave për lirimin/lëshimin e pronave duhet të përmirësohet dukshëm. Implementimi i skemës së qirasë, sidomos kur flitet për mbledhjen e qirasë nga ana e

Agjencisë, mbetet çështje brengosëse. Duhet të përmirësohet bashkëpunimi efikas me forcat policore që të sigurohet zbatimi i dispozitave ligjore relevante.

Jo të gjitha komunat posedojnë regjistra digjitalë për pasurinë e paluajtshme, të lidhur me Regjistrin e Tokave të Kosovës. Disa regjistra të tapive të tokave mbeten në Serbi. Statusi ligjor i vendbanimeve joformale ende nuk është rregulluar dhe komunikimi jo efektiv në mes të autoriteteve komunale dhe atyre qendrore e vështirëson këtë problem.

Në përgjithësi, korniza institucionale dhe ligjore është përforcuar por ka sjellë progres të kufizuar në praktikë në fushën e të drejtave pronësore, i cili është prioritet kyç i Partneritetit Evropian.

Të drejtat e Minoriteteve, të Drejtat Kulturore dhe Mbrojtja e Minoriteteve

Autoritetet Kosovare kane vazhduar me përpjekje të përmirësimit të mbrojtjes, integrimin dhe përfaqësimin e **komuniteteve minoritare**. Këshilli Konsultativ për Komunitete është formuar dhe takohet rregullisht. Komuniteti serb përfaqësohet nga pesë anëtarë, ai turk dhe boshnjak me nga tre, komunitetet rome, ashkalinje, egjiptiane dhe gorane me nga dy dhe komuniteti malazet me një anëtar.

Ministria e Kulturës ka themeluar forumin për shkëmbim teknik të informatave për trashëgimi kulturore në Kosovë, duke përmirësuar në këtë mënyrë koordinimin e aktiviteteve në këtë fushë. Rindërtimi i objekteve ortodokse nëpërmjet Komisionit për Implementimin e Rindërtimit është duke përparuar; tenderimi për punët e rehabilitimit ka filluar në maj. Ligji i ri mbi Doganat i miratuar në nëntor 2008 parasheh lirim nga ngarkesat tatimore dhe taksa të akcizës për aktivitetet ekonomike të Kishës Ortodokse Serbe.

Siguria e objekteve të trashëgimisë fetare dhe kulturore në përgjithësi ofrohet nga Policia e Kosovës, e mbështetur nga KFOR-i. Urdhri policor operativ i shkurtit për mbrojtjen e objekteve kulturore dhe fetare serbe vazhdon të zbatohet.

Megjithatë, ende nuk ka një strategji të integruar për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare. Ligji mbi Mbrojtjen e Zonave Speciale nuk zbatohet plotësisht. Lista e objekteve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore ende nuk është miratuar. Kërkohen sqarime të mëtejme mbi rolin e institucioneve, përfshirë edhe të Këshillit të Trashëgimisë Kulturore. Mosmarrëveshjet mbi pronën tokësore mes disa komunave dhe Kishës Ortodokse Serbe mbesin të pazgjidhura.

Shumica e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe fetare në Kosovë nuk janë të rregulluara në harmoni me planet hapësinore. Vetëm shtatë komuna kanë plane hapësinore të miratuara nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Mbrojtja e zonave nga ndërtimi jo i rregullt në afërsi të objekteve nuk është siguruar. Ligji mbi Planifikimin Hapësinor nuk është implementuar në tërësi.

Në përgjithësi, mbrojtja e trashëgimisë kulturore ka shënuar përparim, por kërkohen përpjekje të mëtejme. Sigurimi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe fetare, përfshirë masat për parandalimin e sulmeve dhe ndjekjen ligjore të sulmeve ndaj objekteve, është një prioritet kyç i Partneritetit Evropian.

Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi vazhdojnë të ofrojnë një mjedis shumë të mbrojtur për të drejtat kulturore të pakicave në fushën e arsimit, gjuhës dhe medieve.

E drejta për **arsimim** publik në të gjitha nivelet për komunitetet jo-shumicë në gjuhën që ata zgjedhin është e garantuar me ligj. Programet mësimore të Kosovës mësohen në tri gjuhë: shqipe, boshnjake dhe turke. Në nivelin e arsimit fillor, ekzistojnë tekstet në të tri gjuhët. Në prill, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë themeloi Komisionin e Pavarur për Shqyrtimin e Programeve Serbe.

Ministria e Shërbimeve Publike monitorin respektimin e përdorimit të **gjuhës** në nivel qendror. Shumica e dokumenteve të nxjerra nga komunat nuk përkthehen në gjuhët zyrtare në përputhje me Ligjin mbi Përdorimin e Gjuhëve.

Ligji po ashtu jep garanci për transmetimin në gjuhë të pakicave nga **mediet** publike, gjë që ka shtyrë Komisionin e Pavarur të Medieve të rifillojë procesin e licencimit. Zyra e Kryeministrit ka miratuar një vendim në dhjetor për themelimin e Fondit për Media Minoritare, që paguhet nga fondet e mbledhura nga RTK.

Megjithatë, implementimi dhe monitorimi mbesin të pamjaftueshëm për të gjitha ligjet që mbulojnë mbrojtjen e të drejtave kulturore të pakicave. Nxënësit nga komunitetet pakicë që flasin gjuhën serbe shpesh shkojnë në shkolla në një sistem paralel të arsimit. Kjo nuk e lehtëson pajtimin dhe shoqërinë shumëetnike në Kosovë. Nxënësit shqiptarë punojnë me plane mësimore sipas ligjit të Kosovës. Nxënësit serbë me plane mësimore sipas ligjit të Serbisë. Mungesa e një plani mësimor të Kosovës në gjuhën serbe paraqet një pengesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve lidhur me qasjen në arsim të fëmijëve nga pakica gorane në komunën e Dragashit.

Librat shkollorë në gjuhët turke dhe gorane nuk janë bërë ende për arsimin e mesëm. Sistemi kosovar i arsimit nuk ofron programe të përshtatura për komunitetet rome, ashkalinje, egjiptiane, gorane, kroate dhe malazeze. Mungesa e dispozitës nga autoritetet komunale për transportim falas të nxënësve nga komunitetet minoritare, mbetet pengesë për integrim. Diplomat kosovare nuk njihen nga autoritetet serbe. Kjo dekurajon studentet serbfolës që të vijojnë një numër edhe ashtu të kufizuar programesh në gjuhë serbe/boshnjake në Universitetin e Prishtinës.

Shumica e komunave nuk kanë nxjerrë ende rregulloren për përdorimin e **gjuhëve**. Kurset e gjuhëve në mesin e shërbyesve civilë janë të pamjaftueshme për ngritjen e dygjuhësisë brenda administratës. Komisioni Qendror për Gjuhë është i organizuar dobët, i mungojnë burimet për të ushtruar mandatin e tij dhe i mungon vizibiliteti në mesin e komuniteteve jo-shumicë.

RTK-ja nuk e plotëson obligimin që të transmetojë 15% të programeve në gjuhë të tjera përveç shqipes. Mbulimi territorial i transmetimit të RTK-së në pjesët minoritare është më i vogël se sa parashihet me ligj (90%). Pasi që Kosova nuk është anëtare në Unionin Ndërkombëtar të Telekomunikimit, ende nuk ka plan për frekuenca ndërkombëtare që do t'u mundësonte kanaleve të TV-së në gjuhën serbe të transmetoheshin në tërë Kosovën.

Në përgjithësi, promovimi i të drejtave kulturore të komuniteteve minoritare të Kosovës duhet të përforcohet.

Furnizimi me energji elektrike në pjesët me shumice serbe, nuk është siguruar plotësisht. Shumica e fshatrave, të banuara kryesisht me serbë të Kosovës, kane nënshkruar marrëveshje kolektive me Korporatën Energjetike të Kosovës. Marrëveshja parasheh pagesën e energjisë në mënyrë të rregullt në baza të konsumit. Akumulimi i borxhit ndaj Korporatës Energjetike të Kosovës është pezulluar.

Situata e komuniteteve minoritare vazhdon të jetë brengosëse. Ka pasur pak progres në drejtim të pajtimit në mes të komuniteteve. Struktura institucionale në nivel qendror duhet të përmirësohet me tej. Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit dhe Zyra për Çështje të Komuniteteve mbetet që të pajtohen për fushat e tyre të përgjegjësi. Shumë persona të komuniteteve minoritare vazhdojnë të përfitojnë nga shërbimet e strukturave paralele për arsimim, mbrojtje sociale dhe përkujdesje shëndetësore. Mungesa e regjistrimit të statusit civil është pengesë shtesë sa i përket qasjes në shërbime.

Ka pasur një numër incidentesh të dhunës ndëretnike kryesisht në Kosovën veriore. Një numër i varrezave ortodokse janë shkatërruar në pjesë të ndryshme të Kosovës. Policia serbe e Kosovës nuk i raporton në mënyrë sistematike rastet dhe incidentet e dhunës ndëretnike. Perceptimi i lirisë së lëvizjes nga disa minoritete mbetet negativ.

Në përgjithësi, ka progres të kufizuar në integrimin e komuniteteve minoritare.

Rreth 850 persona të zhvendosur janë **kthyer** në mënyrë vullnetare në pjesët minoritare të Kosovës, diç më pak se në periudhën paraprake të raportimit. Rreth 200,000 persona nga Kosova mbeten të zhvendosur në Serbi dhe 16,000 në Mal të Zi. Në total 20,000 janë të zhvendosur brenda Kosovës.

Ministria për Komunitete dhe Kthim ka instaluar bazën e të dhënave për regjistrimin e personave të zhdukur brenda dhe jashtë Kosovës. Disa komuna kane sjellë strategji komunale për kthim.

Sidoqoftë, ritmi i kthimeve vullnetare është ende i ulët. Mungesa e mundësive për punësim, mungesa e besimit për zbatimin e të drejtave pronësore dhe perceptimi i kërcënimit të sigurisë janë të cekura si arsye kryesore për këtë. Plani për kthim të disa shqiptareve në Mitrovicën veriore ka rezultuar në fërkime mes serbëve të Kosovës dhe forcave policore, NATO-s, KFOR-it, EULEX-it.

Strategjitë komunale për kthim, nëse janë miratuar, nuk janë jetësuar plotësisht. Udhëzimi dhe përkrahja nga organet qendrore mbeten të pamjaftueshme si dhe mungesa e resurseve financiare ende ekziston. Nuk ka bashkim të forcave mes kornizave të themeluara për kthim vullnetar dhe atij të detyrueshëm. Personat e riatdhesuar nuk kanë qasje në akomodim të përkohshëm. Personave që u nevojitet përkujdesje mjekësore nuk ju ofrohet gjithmonë trajtim mjekësor. Nuk ka mekanizëm monitorues të ri-integrimit.

Vështirësitë me regjistrimin civil janë brengosëse për të kthyerit në Kosovë. Nuk ka ligj për statusin civil. Kosova nuk është palë e Konventës së vitit 1954 për Statusin e Personave pa Shtetësi, as e Konventës së vitit 1961 për Zvogëlimin e Pa-shtetësisë. Nuk ka definicion ligjor për pashtetësinë në Kosovë.

Në përgjithësi, procesi i kthimit vullnetar është ende i kufizuar dhe mbetet sfide për autoritetet kosovare. Qeveria nuk po e implementon në mënyrë të kënaqshme Strategjinë për Ri-integrim të Personave të Riatdhesuar. Krijimi i klimës për pajtim, tolerancë nderetnike dhe shumetnike është prioritet kyç i Partneritetin Evropian.

Në dhjetor qeveria ka sjellë Strategjinë për Integrimin e Komuniteteve **Rome, Ashkalinje dhe Egjiptiane** (RAE) 2009-2015. Në maj, Kryeministri emëroi dy koordinatorë që të adresojnë çështjen e pjesëve të banuara të kontaminuara. Komuna e Mitrovicës ka alokuar truall për ndërtimin e shtëpive për familjet e prekura.

Megjithatë, Komunitetet RAE mbeten të cenuara. Regjistrimi civil dhe posedimi i letërnjoftimeve mbetet çështje e hapur. Qasja e komunitetit RAE në shërbimet publike esenciale (arsimim, mbrojtje sociale, përkujdesje shëndetësore) është ende e kufizuar. Regjistrimi në shkollë i fëmijëve RAE mbetet një problem i madh së bashku me numrin e madh të braktisjes së shkollës. Përqindja e madhe e analfabetizmit ende mbetet e lartë. Nuk ka mjaft mësues të trajnuar romë.

Kushtet e jetesës në disa vendbanime RAE janë brengosëse në mënyrë serioze, posaçërisht kampet e kontaminuara në Cesmin Lug dhe Osterode, së bashku me kampin në Leposaviq, të cilat paraqesin rrezik serioz shëndetësor. Kjo është shkelje e të drejtave elementare të njeriut. Hapa urgjentë duhet të ndërmerren që të adresohet kjo situatë si dhe brengat e disa institucioneve evropiane dhe ndërkombëtare, siç janë Parlamenti Evropian, Këshilli i Evropës dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë.

Në përgjithësi, autoritetet kosovare duhet të ndërmarrin hapa urgjentë ta adresojnë situatën e komuniteteve RAE.

2.3 Çështjet Rajonale dhe Obligimet Ndërkombëtare

Bashkëpunimi i plotë me Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavi (ICTY) është prioritet kyç i Partneritetit Evropian.

Bashkëpunimi mes Kosovës dhe ICTY ka vazhduar gjatë periudhës raportuese. Bisedime në mes ICTY, UNMIK-ut dhe EULEX-it për aranzhimin e bashkëpunimit në të ardhmen janë në progres duke marre parasysh konfigurimin e UNMIK-ut.

Në përgjithësi, përfaqësimi i jashtëm i Kosovës mbetet sfide. Autoritetet Kosovare duhet të marrin një këndvështrim më konsekuent dhe konstruktiv. UNMIK-u është nënshkruar në emër të Kosovës i disa marrëveshjeve ndërkombëtare si dhe iniciativave rajonale (Energy Community Treaty, European Common Aviation Area Agreement, South East Europe Transport Observatory, Central European Free Trade Agreement-CEFTA, Regional Cooperation Council). Në bazë të Kushtetutës, autoritetet kosovare sigurojnë përfaqësimin rajonal dhe ndërkombëtar të Kosovës. Megjithatë autoritetet kosovare nuk pranohen si pasardhës i UNMIK-ut nga disa palë të këtyre marrëveshjeve.

UNMIK-u ka lehtësuar aty ku ishte e mundur, aranzhimet që të bëjë të mundshme pjesëmarrjen e Kosovës në forumet rajonale. Këndvështrimi i Kosovës për UNMIK-un nuk ka qene koherent. Kjo ka sjellë deri tek aranzhime të atypëratyshme (ad hoc) në disa raste. Qeveria duhet të zhvillojë strategji gjithëpërfshirëse për përfaqësim të jashtëm si dhe për anëtarësim në organet ndërkombëtare dhe organizatat.

Përfaqësuesit kosovarë nuk kanë mundur të marrin pjesë në të gjitha evenimentet e mbajtura në ato vende të cilat nuk e njohin Kosovën, për shkak të vështirësive për përdorimin e pasaportës kosovare. Këto ngjarje kane ndodhur me një frekuence të shtuar dhe kështu duke penguar zhvillimin efektiv të bashkëpunimit rajonal BE ka shprehur që bashkëpunimi rajonal duhet të përfshihet në mënyre që të jetë e suksesshme dhe ka shprehur keqardhje për mosmarrëveshjet në lidhje me mënyrën së si përfaqësohet Kosova në forumet rajonale, kane rezultuar me mungesën e Kosovës në evenimente kyçe rajonale. Për këtë arsye është esenciale të sigurohet pjesëmarrja e Kosovës në forumet multilaterale, dhe të gjitha palët e interesuara të dëshmojnë qasje konstruktive dhe fleksibile në këtë aspekt.

Përfaqësuesit e Kosovës nuk kane mundur të marrin pjesë në Takimin Vjetore të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, dhe Samitin e Procesit për Bashkëpunim të Evropës Jug-Lindore (SEECP), të mbajtur në Chisinau në qershor 2009, për arsye së autoritetet e Moldavisë nuk u kane lëshuar viza atyre.

Në dhjetor 2008, Kosova ka emëruar përfaqësuesin e saj në Komitetin Drejtues të Shkollës Rajonale për Administratë Publike (ReSPA). Megjithatë, pjesëmarrja e vazhdueshme Kosovës është në rrezik pasi që Kosova ende nuk ka nënshkruar ReSPA marrëveshjen. Kosova nuk ka marre pjesë në mënyre sistematike në takimet e përbashkëta të komitetit dhe nenkomiteteteve të CEFTA. Nuk është gjetur ende një pajtueshmëri mbi mënyrën së si Kosova duhet të përfaqësohet në këto takime.

Ka pasur incidente ku hyrja në Kosove u është ndaluar zyrtareve të lartë të Serbisë. Autoritetet kosovare kane insistuar që vizitat e tilla të lajmërohen përmes kanaleve adekuate diplomatike. Bashkëpunimi konstruktiv në çështjet që kane të bëjnë me Serbinë është prioritet kyç i Partneritetit Evropian.

Në shkurt dhe mars 2009, Kosova ka aprovuar legjislacionin i cili nuk është në pajtueshmëri me detyrimet e veta që dalin nga European Common Aviation Area Agreement (ECAA). Deri sa ky legjislacion nuk tërhiqet, implementimi i fazës së parë të përkohshme të ECAA Agreement mbeten pikëpyetje.

Kosova është pjesëmarrëse në South East Transport Observatory (SEETO). Në dhjetor 2008, Kosova morri pjesë në takimin vjetor të 4-të të Ministrave në lidhje me Zhvillimin e Rrjetit Rajonal Transportues për Evropën Juglindore në Mal të Zi, nga e cila u lancuan negociatat për traktat mbi themelimin e Komunitetit të Transportit në mes të Ballkanit Perëndimor.

Kosova ka vazhduar të marrë pjesë si vëzhgues in the Investment Compact for Southern Europe (SEE), e dizajnuar që të përmirësojë klimën investuese dhe inkurajojë zhvillimin e sektorit privat në rajon.

Ka pasur pak progres në demarkacionin me FYROM; ky proces duhet të kompletohet. Nuk ka bisedime për demarkacion me vendet e tjera fqinje.

Në përgjithësi, pjesëmarrja e Kosovës në iniciativat për bashkëpunim rajonal duhet të jetë me konstruktive dhe pragmatike. Është me rëndësi që Kosova të marrë pjesë në forumet rajonale dhe të mbajë hapin me progresin e bërë në fushat kyçe në tërë rajonin.

3. Kriteret Ekonomike

Komisioni Evropian i është qasur analizës së Zhvillimit Ekonomik të Kosovës duke i përdorur konkluzionet e Këshillit Evropian të Kopenhagës të qershorit të vitit 1993, të cilat thonë, “anëtarësimi në Bashkim Evropian kërkon një ekonomi funksionale dhe të orientuar nga tregu, e aftë për t’u ballafaquar me kapacitetet konkurruese dhe me forcat e tregut në Kuadër të Bashkimit Evropian.

3.1 Ekzistimi i një ekonomie funksionale të tregut

Bazat e Politikave Ekonomike

Qeveria e Kosovës ke aprovuar Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) të katërt me radhe e cila mbulon periudhën kohore prej 2010 -2012. Sidoqoftë, ky dokument nuk është përdorur si dokument për planifikimin e politikave. Kursi i paraqitur në KASH për balancimin fiskal dhe atij të jashtëm duket të jetë i vështirë për tu mbajtur dhe së në të njëjtën kohë Letra e Bardhë lidhur me politikat sociale nuk është përfshirë fare edhe përkundër premtimit të marrë nga autoritetet me 2008 në Konferencën Ndërkombëtare të Donatorëve. Në përgjithësi, ligjet e reja të cilat nuk ndërlidhen me KASH apo me ndonjë dokument tjetër kornize afatmesëm, vazhdohet të pranohen në qeveri. Sundimi i dobët i ligjit vazhdon që të mbetet pengesë kryesore për zhvillimin socio-ekonomik.

Takimi i parë me Komisionin Evropian i mbajtur në Prishtinë lidhur me mekanizmin për mbikëqyrjen fiskale është organizuar në mars të Vitit 2009. Ndërsa me 29 qershor 2009, Kosova bëhet anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtare (FMN) dhe Bankës Botërore (BB).

Në përgjithësi, konsensusi politik lidhur me fundamentet e ekonomisë së orientuar nga tregu ka qenë i trajtuar. Sidoqoftë, korniza ligjore si dhe praktika e menaxhimit modern të financave publike ende mungon.

Administrata publike nuk ka kapacitete të mjaftueshme.

Stabiliteti Makroekonomik

Rritja reale e BPV në vitin 2008 ka qenë 5.4% krahasuar me 5.0% sa ishte vitin 2007. Ndryshe nga viti 2007 ku dinamizmi i sektorit privat ishte burim kryesor i zhvillimit ekonomik, aktivitetet ekonomike në vitin 2008 dhe në gjysmën e parë të vitit 2009 janë udhëhequr në masë të madhe me rritjen e shpenzimit të kapitalit publik. Rritja vjetore në konsumin privat qëndroi në 11.3%, e konsumit publik në 3%, përderisa investimet publike u rritën për 194%, investimet e sektorit privat kanë pësuar rënie prej 10.2%. Kjo e fundit ka ndodhur për shkak të rënies së Investimeve të Huaja Direkte (IHD) si dhe të ngecjes të procesit të privatizimit. Si pasojë e krizës globale ekonomike që nga fundi i vitit 2008, eksportet kane filluar që të pakësohen. Qasja e kufizuar e Kosovës në Ekonominë Globale si dhe sektori financiar i qëndrueshëm i cili ka përcjellë strategjitë konservative, ka ndikuar që të shmanget përkohësisht ndikimi i krizës globale. Për më tepër, dobësia e sistemit statistikor nuk lejon një vlerësim me të përgjithshëm të situatës ekonomike në Kosovë.⁶

Bazuar në vlerësimet e FMNs, BPV për kokë të banorit⁷ në vitin 2008 arriti në €1,726, që korrespondon me 6.9% të mesatares së EU -27 krahasuar me 6.5% në vitin 2007.

Në përgjithësi, duke mos e zbuluar efektet edhe ashtu të limituara të krizës në Ekonominë Kosovare deri me tani, mungesa e të dhënave nuk ka lejuar një hulumtim me të gjere për vitin e paraprak dhe për vitin aktual.

Në vitin 2008 eksportet e mallrave janë rritur për 20.2% duke e arritur 5.3% të BPVs. Sikurse në vitin e kaluar eksporti është bazuar në metale bazë dhe në produktet e metaleve bazë, duke u vlerësuar në mbi 60% të eksporteve të gjithëmbarshe në vitin 2008 dhe duke kaluar 67% atë të vitit 2007. Kategoria e dytë me e rëndësishme e eksportit janë produktet e mineraleve, të cilat kane treguar një rënie prej 32% në vitin 2008 *vis a vi* vitin 2007, e gjithë kjo për shkak të rënies së kërkesës nga jashtë si pasojë e krizës globale. Në gjysmën e parë të vitit 2009 eksportet kanë rënë në mënyrë të ndjeshme 39.9%, ku metalet bazë kane pësuar rënie afërsisht për 60%.

Importet e mallrave janë rritur në 22.1% në vitin 2008 duke arritur shkallen prej 50% të BPVs krahasuar me 44.2% të BPV për vitin 2007. Produktet minerale (kryesisht nafta) ushqimet e gatshme, metalet bazike dhe makineria ende mbesin kategoritë kryesore të

⁶ Enti Statistikor i Kosovës (ESK) ka publikuar të dhënat nominale të BPV për vitin 2004-2007, duke theksuar në të njëjtën kohe numrin dhe kualitetin jo të mjaftueshëm të hulumtimeve ekzistuese të cilat do të mundësonin implementimin e suksesshëm të kontabilitetit kombëtare bazuar në standardeve ESA 95.

⁷ Njësia matëse për Paritetin e Fuqisë Blerëse nuk është në disponim për Kosovën.

importit. Importi i përgjithshëm pësoi rënie prej 1.6%, megjithëse 2/3 e grupeve të mallrave ende shënojnë rritje pozitive.

Përpjesëtimi në mes të Eksportit dhe Importit të të mirave (tradicionalisht të ulëta), kanë pasur rënie deri në 6% në nëntor të vitit 2008 (nga 17% në qershor të vitit 2007) pasi që eksporti është zvogëluar me paraqitjen e krizës ndërkombëtare. Eksporti ka vazhduar që të bie që prej atëherë. Si pasojë e kësaj deficiti tregtar është zgjeruar në 46% të BPV në gjysmën e parë të vitit 2009, pra prej 43% në vitin 2008 dhe 39% në vitin 2007.

Deficiti momental – duke përfshirë këtu edhe grantet zyrtare – janë rritur nga 10.2% të BPV në vitin 2007 deri në 16.3% në vitin 2008. Remitencat dhe asistencat nga jashtë vlerësohen në 12.1% të BPV (12.5% në vitin 2007) si dhe 7.7% të BPV. Në vitin 2007 diku rreth gjysma e IHD kanë qenë të lidhura me procesin e privatizimit si dhe licencimi i operatorit të dytë mobil, përderisa në vitin 2008 procesi i privatizimit ka shënuar ngecje. Sikurse në vitet e mëhershme bilanci neto i kapitalit dhe i gjendjes financiare vazhdon të mbetet më i ulët se sa deficiti momental, duke e lënë të pashpjeguar pjesën financiare. Në përgjithësi, përshtatja e deficitit të lartë tregtar në gjysmën e parë të vitit 2009 nuk ka ndodhur pasi që punët e mëdha publike kanë iniciuar importe substanciale të makinerisë dhe pajisjeve transportuese, përderisa eksporti ka rënë në mënyre rapide.

Dispozicioni dhe besueshmëria e varfër e të dhënave për tregun e punës vazhdojnë të pengojnë analizimin e zhvillimit të këtij tregu. Papunësia e regjistruar në gjysmën e parë të viti 2009 mbetet shumë e lartë, e vlerësuar deri në 40% dhe e pandryshuar që nga viti 2008. Më shumë se 90% të personave të regjistruar renditen në grupin personave të papunësuar në afat të gjatë. Huluntimi i fuqisë punëtore gjithashtu e konfirmon papunësinë e nivelit të lartë diku rreth 40%. Ekziston pasiguria lidhur me saktësinë e këtyre shifrave. Këto janë bazuar në faktin që dihet pak lidhur me çështjen se sa prej atyre që janë të regjistruar si të papunësuar janë faktikisht ekonomikisht jo aktivë dhe që në mënyre aktive kërkojnë punësim. Rreth 30000 të rinj hyjnë në tregun e punës çdo vit dhe shumë prej tyre vazhdojnë të lëshojnë Kosovën për të gjetur punë jashtë vendit. Fuqia punëtore është në fakt përben eksportin me të madh të peregjistruar dhe fuqia punëtore që punon jashtë vendit vazhdon të prodhojë një rrjedhje konstante të të ardhurave në forme të remitencave që financon një pjesë të madhe të konsumit në Kosovë. Sidoqoftë, nuk ka të dhëna statistikore zyrtare lidhur me migrimin e fuqisë punëtore. Në përgjithësi, niveli i aktivitetit ekonomike nuk i lejon forcës punuese të re dhe në rritje që të absorbohet. Për shumicën, emigrimi dhe puna jashtë vendit mbesin e vetmja zgjedhje e mundshme për të mbajtur familjet e tyre në Kosovë.

Inflacioni i çmimit mesatar vjetor të konsumit është rritur në 9.4% në vitin 2008 nga 4.3% në vitin 2007. Rata mujore të inflacionit në baza vjetore është kthyer në negative në vitin 2009, duke arritur -3.0% në muajin gusht. Kosova është prekur fuqishëm nga çmimi i lartë i ushqimit dhe i energjisë në mes të gjysmës së viteve 2007 dhe 2008, pjesërisht për shkak të hiseve me të mëdha të produkteve ushqimore ICK, por gjithashtu për shkak të nivelit të ulët të konkurrencës në ekonomi. Shtytësit kryesorë që qëndrojnë prapa ratës negative të inflacionit në kohët e fundit janë përshtatja e çmimeve të ushqimit dhe kostoja më e ulët për transport. Nga ana tjetër, çmimet e kostove shtëpiake, duke e përfshirë

energjinë dhe disa shërbimeve që janë kryesisht publike, janë ende në rritje. Në përgjithësi, zhvillimet e çmimeve reflektojnë rënien e çmimeve ndërkombëtare. Çmimet e shërbimeve vendore kanë vazhduar të rriten, pjesërisht për shkak të presionit të dobët të konkurrencës në ekonomi.

Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka ngritur fushën e saj në mbikëqyrjen e sektorin financiar dhe ka luajtur një rol pozitiv në menaxhimin e rreziqeve të lidhura me krizën financiare ndërkombëtare. Po ashtu ka lansuar monitorimin me frekuencë të lartë të Bankave Komeriale. Duke pasur parasysh që Banka Qendrore është institucioni kryesor për rregullimin e tregut financiar dhe mbikëqyrjen në Kosove, pasi që Kosova e përdorë Euron si valute zyrtare, BQK ka të kufizuar instrumentet politike në dispozicion, sikur rezervat dhe kërkesat për likuiditet. Në mungese të një politike të pavarur monetare dhe marrë parasysh euro-izimin e plotë të ekonomisë, normat reale të interesit dhe norma reale (efektive) e këmbimit mbesin të vështira për t'u parashikuar. Pasiguritë për të drejtat pronësore dhe sundimi i dobët i ligjit vazhduan të jenë faktorët kryesorë për premtimet e larta të rrezikut të kërkuara nga bankat komerciale. Përgjithësisht, stabiliteti i sektorit financiar ka përfutur nga përmirësimi i mbikëqyrjes.

Pas vitit 2007 ekzekutimi i buxhetit ka lëvizur drejt një rritjeje substanciale në rezerva të parave të gatshme (cash) të Qeverisë, viti fiskal 2008 ka përfunduar gjerësisht i balancuar dhe rezervat kesh të Qeverisë janë mbyllur me afro 470 milion. Të ardhurat e përgjithshme kanë rënë prej 25.9 % të GDP në 2007, në 25.3. % të GDP në 2008. Të hyrat e mbledhura nga Shërbimi Doganor përbejnë 64 % e të hyrave totale të Qeverisë, prej 58.9 % në 2007. Shpenzimet totale janë rritur për 44.0% në 2008, duke arritur 25.3% të GDP, prej 18.9% të GDP në vitin 2007. Pagat janë rritur për 9.3%, subvencionet dhe transferet për 32.6%, dhe shpenzimet kapitale gati janë trefishuar (194.4%) në krahasim me vitin 2007. Për rrjedhim Investimet Publike janë arritën në 7.7% të GDP, nga 2,8% sa ishte në vitin 2007. Shpenzimet kanë treguar një pamje shume të paqëndrueshme. Në pjesën e parë të vitit 2009 shpenzimet qeveritare kanë vazhduar të rriten - pagat dhe mëditjet me 17 %, subvencionet dhe transferet u rriten për 25.4% që gjithashtu kanë pasur një bazë të fortë në vitin 2008, shpenzimet kapitale ishin 34.8 % me të larta së sa gjate pjesës së parë të vitit 2008.

Në pjesën e parë të vitit 2009 të hyrat publike nuk ishin të ndikuara ndjeshëm nga kriza financiare dhe ato janë rritur nga 2.9% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2008. Në përgjithësi buxheti i vitit 2008 dukshëm ka shënuar rritje të shpenzimeve në investime kapitale, subvencione dhe transfere. Në pikëpamje të sfidave të një ambienti ekonomik, të hyrat e mbledhura në pjesën e parë të vitit 2009 janë mbajtur mirë.

Në lidhje me planet fiskale, Ministria për Ekonomi dhe Financa ka vazhduar të pranojë informata jo-komplete nga Ministrinë përkatëse të rëndësishme për zhvillimet strategjike me implikime financiare.

Një shembull i mire është përfshirja e kufizuar e Ministrisë në transformimin e sektorit të energjisë në pronësi të shtetërore, pavarësisht nevojave të saj të larta dhe në rritje për transfere dhe subvencione nga buxheti.

Buxheti 2009 ka qene i ndikuar nga agjenda elektorale⁸ dhe ka vazhduar rritjet në pagat publike, që për pasojë ka shtyre në prishjen e rregullit fiskal sikur është e paraqitur në KASH e mëparshëm. Qeveria po ashtu ka vazhduar të inicioje legjislacion pa i lidhur ato me KASH apo dokumente tjera afatmesme planifikuese që do të mund të siguronin ndonjë konsistence të politikave me kohë. As buxheti dhe as KASH⁹ nuk janë zhvilluar në instrumente efektive të politikave. Në vend të kësaj të fundit, ato vazhduan të përgjigjen në kërkesa ad hoc të presioneve të shpenzimeve.

Përgjithësisht, pasur parasysh mungesën e politikës së pavarur monetare, barra e përshtatjeve makroekonomike mbeti me politiken fiskale; sidoqoftë, kualiteti i dobët i planifikimit buxhetor dhe ekzekutimit tregon së duhet që akoma të marre si të vërtetë përgjegjësinë për stabilitetin makroekonomik.

Bashkëveprimi i Forcave të tregut

Komisioni i Konkurrencës ka filluar me implementimin e politikave të konkurrencës. Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ka zëvendësuar Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit në qershor 2008.

AKP ka rifilluar me procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në pjesën e dytë të vitit 2008 megjithëse me ritëm modest dhe me numër modest të ndërmarrjeve, përpunimi i aseteve të kufizuara, si pasojë pa ndikim të qarte për aktivitete ekonomike në përgjithësi. Nga prilli i 2009 ka pasur një përshpejtim të lehtë në procesin e privatizimit.

Agjenda e privatizimit për Qeverinë në lidhje me privatizimin e ndërmarrjeve publike ka vazhduar me akumulimin e vonesave. Në përgjithësi vonesa në privatizim ka kontribuar në strukturën rixhide të biznesit.

Hyrja dhe dalja në treg

Deri nga fundi i vitit 2008, 67,950 kompani janë aktive, ku 83% prej tyre operojnë në sektorin e shërbimeve. Përmirësime janë bërë në “One Stop Shop” mundësitë për regjistrimin e bizneseve, por kostot fikse për të bërë biznes, sikur puna dhe lejet për ndërtim mbesin të larta. Përgjithësisht, administrata dhe sundimi i ligjit i dobët, furnizim i pasigurt i energjisë, qasja e kufizuar në financa, korrupsioni dhe të drejtat e pronësore të definuara dobët, adresimi i të cilave është përmendur si prioritet kyç në Partneritetin Evropian 2008, i pengojnë hyrjet dhe daljet në treg.

Sistemi Ligjor

Nevoja e forcimit të kuadrit ligjor është një prioritet kyç në partneritetin Evropian 2008, sistemi ligjor i Kosovës ka një përzierje komplekse e akteve të ndryshme ligjore të prodhuara nga administrata jugosllave para vitit 1999, dhe duke pasuar nga UNMIK-u

⁸ Në kohën kur u përgatit buxheti për 2009, puna e bazuar në pakon e Ahtisaarit parashihte mbajtjen e zgjedhjeve të përgjithshme në vitin 2009.

⁹ Rregulli kufizonte rritjen e shpenzimeve primare deri në 0.5% të rritjes së përgjithshme ekonomike.

dhe Qeveria e Kosovës që atëherë, ku kjo situatë ka shkaktuar paqartësi. Si rregull kryesore, legjislacioni pas 1999 ka qenë shumë përkrahës i ekonomisë së lire të tregut. Sistemi ligjor ka vazhduar që të shfaqë një afrueshmëri dhe efikasitet të dobët, dhe disa zona nuk janë të mbuluara nga gjykatat përkatëse. Si pasojë, metodat informale të zbatimit të kontratës vazhdojnë të jenë të përhapura. Sektor i madh informal është mbushur nga dobësitë e taksave dhe politikave të shpenzimeve, si dhe në zbatimin e ligjit, duke përfshirë luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Sektori informal mbetet një sfidë e rëndësishme, meqë ai zvogëlon bazën tatimore dhe efikasitetin e politikave ekonomike.

Në përgjithësi, sundimi i dobët i ligjit dhe pasiguria mbi të drejtat e pronësisë mbeten pengesë e madhe për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Zbatimi i vështirë dhe i kushtueshëm i kontratave ligjore ka penguar qasjen në financa dhe vazhdon të pengojë seriozisht mjedisin e biznesit

Zhvillimi i sektorit financiar

Sektori financiar në Kosovë ka vazhduar të zgjerohet, edhe pse me një shpejtësi mjaft të ngadalësuar në krahasim me vitet e kaluara. Në Kosovë deri më tani operojnë tetë banka komerciale, dhjetë kompani të sigurimeve dhe dy fonde pensionale. Banka Qendrore e Kosovës ka reaguar ndaj krizës financiare ndërkombëtare me themelimin e Komitetit të Gatishmërisë për Krizë dhe nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit për mbrojtjen e stabilitetit financiar me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Këto procedura të sapo krijuara ende nuk janë testuar. Kërkesat raportuese për bankat janë shtrënguar dhe atyre u është kërkuar që gradualisht ta ulin ekspozimin e tyre net ndaj bankës amë në nivelin e caktuar nga BQK (20% e kapitalit Tier I). Ka pasur rritje në shkëmbimin e informatave me banka qendrore të huaja dhe autoritete të tjera mbikëqyrëse, si dhe me bordet e akterëve kyçë në sektorin bankar. Cilësia e portofolit të kredive në sektorin bankar të Kosovës mbetet solide, me pjesëmarrje mesatare të kredive jo performuese prej 3.3% në 2008 nga 4.4% në 2007. Në përgjithësi, treguesit e profitabilitetit dhe likuiditetit në 2008 kanë mbetur të favorshëm dhe deri më tani nuk ka pasur nevojë për ndonjë intervenim specifik që ka të bëjë me krizën. Megjithatë ekzistojnë disa tregues për qasjen e dobët në financa dhe perceptim i lartë për rrezikun në lidhje me biznesin.

Sektori bankar vazhdon ta dominojë sektorin financiar dhe mbetet mjaft i koncentruar, ku tri bankat më të mëdha, që janë të huaja, përbëjnë gati 90% të asetëve totale. Profiti u rrit me 8.7% në 2008, rënie e mprehtë nga rritja 68% në 2007. Shkalla e ndërmjetësimit financiar vazhdoi të rritet, por megjithatë me një nivel modest. Përqindja e asetëve të sektorit bankar në BPV u rrit prej 41.4% në 2007 në 48.6% në 2008. Vëllimi i kredive u rrit nga 25.8% të BPV-së në 2007 në 31.8% në 2008. Në maj 2009, rritja vjetore e kredisë ishte 20.4%, rritja e depozitave ishte 21.4%, ndërsa raporti i kredive me depozitat ishte 84.5%. Edhe pse me ligj nuk është e obligueshme, ekziston një marrëveshje joformale sipas së cilës raporti i kredive me depozita nuk duhet të kalojë 80%. Që nga Shkurti 2008, ky raport vazhdimisht ka qenë mbi këtë nivel, pasi që rritja e kredisë është lidhur ngushtë me normën e rritjes së depozitave. Dallimi i normave të interesit në mes depozitave dhe kredive ka mbetur shumë i lartë dhe ka shënuar vetëm një trend të ngadalshëm të uljes.

Deri në fund të majit 2009, mesatarja e këtij dallimi për 12 muaj për të gjitha llojet e kredive ka qenë 10.1 pika të përqindjes, një ulje e vogël nga 11.3 pika të përqindjes në 2007. Dallimi për kreditë familjarëve (9.2) është më i ulët së për kreditë korporatave (jo financiare), (11.2). Shpërndarja e kredive përgjatë sektorëve qëndron jo shumë e nivelizuar. Deri në fund të majit 2009, bujqësia vazhdoi të ketë vetëm 4% të kredive për biznes të pashlyera, sektori sekondar (përpunimi, energjia, dhe ndërtimtaria) deri 21%, ndërsa 75% e të gjitha kredive për biznes kanë financuar aktivitete në sektorin e shërbimeve. Përderisa nuk ka pasur ndryshim në strukturën sektoriale të portofolit të kredive, ka pasur përparim në strukturën e maturitetit. Deri në fund të majit 2009, 62% e kredive për biznes kanë pasur maturitet prej 2 apo më shumë vjet, një rritje nga 57% në fund të 2007.

Në përgjithësi, numri i kredive është rritur por normat reale të larta të interesit mbeten një prej pengesave kryesore për zhvillimin e biznesit në Kosovë. Zbatimi jo efektiv i të drejtave të kreditorëve dhe të kontratave vazhdon të bartë çmim dhe rreziqe të larta për institucionet financiare, siç është e reflektuar me përhapje të lartë të interesit, dhe dobëson vlerën e huas plotësuese (kolateralit).

3.2 Kapaciteti për të përballuar tensionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda BE-së

Ekzistenca e ekonomisë së tregut që funksionon

Që nga 1999, legjislacioni i miratuar rishtazi mbështetë një ekonomi të lirë tregu. Megjithatë, ka pasur mjaft pak progres në forcimin e kornizës së përgjithshme për një ekonomi të tregut që funksionon. Korniza rregullative është e pa kompletuar në shumë fusha relevante për ekonominë, zbatimi dhe jetësimi i rregullave ekzistuese mbetet i dobët, dhe ka mungesë të qeverisjes së mirë. Po ashtu, dispozitat për zbatimin e legjislacionit kyç mungojnë apo janë kontradiktore. Kompanitë në sektorin privat janë të ballafaquara me procedura të prokurimit dhe tenderimit me mungesë transparence, rregulla të qëndrueshme administrative dhe kontroll financiar, si dhe vlerësime të ndikimit ekonomik. As agjencitë e prokurimit as gjykatat nuk kanë qenë të afta që të bëjnë zbatimin arbitrar të kritereve të përzgjedhjes në mënyrë të suksesshme. Stabiliteti i furnizimit me energji është përmirësuar, por ka kushtuar me rritje të subvencioneve nga buxheti.

Në përgjithësi, korniza ligjore e pakompletuar, korrupsioni, sundimi i dobët i ligjit, niveli i lartë i aktiviteteve joformale dhe furnizimi shumë i subvencionuar i energjisë vazhduan ta dëmtojnë efikasitetin e mekanizmave të tregut.

Kapitali njerëzor dhe fizik

Pak progres ka shënuar sektori i arsimit, sidomos sa i përket akreditimit dhe kualifikimeve, dhe konsolidimit të universitetit. Përkundër kësaj, sistemi arsimor vazhdoi të vuajë nga mungesa e resurseve dhe kualifikimeve të mangëta ose jo të besueshme dhe

skemat certifikuese. Norma mesatare e punësimit në arsim nuk ka treguar rritje domethënëse në vitet e fundit. Është posaçërisht e ulët në arsimin e mesëm dhe të lartë, dhe niveli i braktisjes është i lartë. Në përgjithësi, pak progres ka pasur në drejtim të zhvillimit më të mirë të potencialit ekonomik të popullsisë së re të Kosovës.

Nuk ka në dispozicion informata gjithëpërfshirëse në zhvillimet ndaj investimeve. Kosova ka iniciuar punë të mëdha publike për ta modernizuar rrjetin rrugor, duke absorbuar një pjesë më të madhe të resurseve të buxhetit. Megjithatë, procedurat e dobëta të prokurimit dhe kontrollit financiar vënë dyshime në cilësinë dhe kapacitetin për të reaguar ndaj nevojave aktuale të punëve në vazhdimësi, si dhe në cilësinë e punëve aktuale. Penetrimi i telefonisë mobile vazhdon të rritet dhe është vlerësuar në më shumë se 50% deri në mes të 2009. Në përgjithësi, baza teknologjike dhe gjendja fizike e infrastrukturës mbeten të dobëta dhe fondi i kapitalit njerëzor të kualifikuar mbetet i vogël. Si rezultat, kompanitë kosovare janë shumë rrallë konkurruese edhe aty ku ekziston potenciali konkurrues.

Struktura sektoriale dhe e ndërmarrjeve

Autoritetet rregullative janë themeluar për të gjitha industritë kryesore të rrjeteve dhe mallrave, por ato kanë mbetur të dobëta. Pavarësia e tyre është penguar nga politizimi i të caktuarve në bordet e tyre. Në disa raste, efektet pozitive potenciale të liberalizimit të tregut nuk mund të materializohen për shkak të qeverisjes së dobët të korporatave dhe mungesës së mbrojtjes së konsumatorit. Kosova ende nuk mund të përfitojë nga tregtia rajonale e energjisë më fqinjët e saj në nivel të barabartë për shkak të integritetit të pakompletuar në marrëveshjet rajonale të tregtisë së energjisë. Furnizimi me rrymë vazhdon të jetë me ndërprerje për shkak të një sistemi të vjetër dhe tendosje të shkaktuara nga një rritje e kërkesës që nuk mund të përballohet. Përderisa mbledhja e faturave është rritur pak, diku 50% të rrymës që prodhohet nuk paguhet. Kërkesa për elektricitet vazhdon të rritet më shpejtë se rritja ekonomike. Një central i ri elektrik do të fillojë punën së paku pas pesë vjetësh. Shturja e mëturjes dhe privatizimi i kompanive të gjenerimit dhe shpërndarjes është planifikuar për vitin e ardhshëm. Struktura e ndërmarrjeve nuk ka ndryshuar, ajo është e dominuar nga ndërmarrjet e vogla. Janë marrë masa për të filluar me zvogëlimin e një ekonomie të madhe joformale, si kontrollimi i sistemit tatimor, dhe masat e marra për të adresuar evazionin e tij. Në përgjithësi, ka pasur disa ndryshime në strukturën e ndërmarrjeve, e cila mbetet e dominuar nga ndërmarrjet e vogla, dhe ekonomia e madhe joformale mbetet sfidë.

Ndikimi i shtetit në konkurrencë

Sipas të dhënave të buxhetit, subvencionet dhe transferet u rritën 32.6% në 2008 dhe edhe me 25.4% më shumë në gjysmën e parë të 2009. Një pjesë e madhe e tyre shkojnë në kompaninë publike të elektricitetit - KEK, e cila shënon humbje. Vjedhja e gjerë e elektricitetit dhe toleranca ndaj borxheve të papaguara të elektricitetit ka dobësuar aftësitë e centralit elektrik, dhe ka vazhduar të nxitë importe tjera të energjisë të paguara nga buxheti i qeverisë. Në përgjithësi, subvencionet konstante direkt dhe jodirekte të shtetit,

të kombinuara me një shkallë të dobët të cilësisë së shërbimeve publike, vazhduan të pengojnë aftësitë konkurruese të sektorit privat.

Integrimi ekonomik me BE-në

Hapja e ekonomisë, e matur nga vlera e shumës së importeve dhe eksporteve të të mirave materiale dhe shërbimeve si përqindje e BPV-së, u rrit në 71.1% në 2008, ngritje nga 64.5% në 2007. Vendet anëtare të BE-së dhe CEFTA vazhduan të jenë dy partnerët kryesorë tregtarë të Kosovës, secila duke përbërë 40% të tregtisë, e dyta përkundër bllokimit të eksporteve nga Serbia dhe refuzimi i trajtimit preferues nga Bosnja e Hercegovina. Pjesa e eksporteve të destinuara për BE u rrit nga 42% në 2007 në 47.8% në 2008. Pjesa e importeve të BE-së mbeti 36% e importeve totale. Në përgjithësi, integrimi ekonomik me BE-në është rritur.

4. Standardet evropiane

Ky seksion shqyrton aftësinë e Kosovës që gradualisht të përafrojë legjislacionin dhe politikat e saj me ato të *acquis* në lidhje me tregun e brendshëm, politikave sektoriale dhe të drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, në përputhje me Procesin e Stabilizim-Asociimit dhe prioritetet e Partneritetit Evropian. Gjithashtu analizon kapacitetet administrative të Kosovës. Në çdo sektor, vlerësimi i Komisionit mbulon përparimin e arritur gjatë periudhës raportuese, dhe përmbledh nivelin e përgjithshëm të përgatitjes.

4.1. Tregu i brendshëm

4.1.1. Lëvizja e lirë e mallrave

Ka pasur një përparim në fushën e **standardizimit**. Këshilli profesional i Standardizimit është operacional. Nëntë komitete teknike (në të cilat kompanitë marrin pjesë në mënyrë aktive) janë krijuar në fushat e produkteve të ndërtimit, naftë / gaz, cilësisë, sistemet e menaxhimit, transportit dhe shërbimeve postare, elektro-teknologji, metrologji, kujdes shëndetësor, energji dhe përpunim të drurit.

Deri më sot, rreth 1200 EN dhe ISO / IEC-standarde bazë janë adoptuar si standarde të Kosovës, nga të cilët rreth një e katërta janë harmonizuar me standarde evropiane në fushën e produkteve të ndërtimit. Agjencia Kosovare për Standardizim brenda Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është përgjegjëse për standardizimin. Ky institucion nuk është anëtar i një organizate evropiane ose ndërkombëtare të standardizimit.

Progresi mbetet shumë i kufizuar për **vlerësimi i përshtatshmërisë**. Funkcionimi i sistemit të vlerësimit të përshtatshmërisë e nuk është ende në fuqi.

Është bërë përparim për akreditim. Ligji për Akreditim u miratua në dhjetor të vitit 2008; Dispozitat zbatuese janë miratuar. Katër organet e vlerësimit të përshtatshmërisë (një organ inspektues dhe laboratorëve të testimit tri) janë akredituar në Kosovë deri më tani.

Drejtoria e akreditimit është themeluar brenda Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Një komision teknik për testim dhe kalibrim të punës është ngritur. Në maj të këtij viti është nënshkruar një memorandum i mirëkuptimit me Republikën ish-Jugosllave të Maqedonisë.

Ka pasur një përparim të kufizuar në **metrologji**. Aktivitetet metrologjike kryhen nga Departamenti i Metrologjisë dhe institutit ligjor të Metrologjisë dhe Inspektimit, e cila ka dy zyra. Një në Prishtinë, që merret me matjen mekanike dhe elektrike. Ndërsa Zyra tjetër në Prizren mbulon matjet mekanike dhe kontrollet e artikujve nga metalet e çmuara. Këshilli metrologjik drejton zhvillimin e përgjithshëm të metrologjisë. Megjithatë, Laboratori qendror për metrologji i Kosovës ende nuk është ngritur. Strategjia për zhvillimin e infrastrukturës metrologjike për periudhën 2009-2013 nuk është miratuar.

Mbikëqyrja e tregut nuk ka përparuar. Përgatitjet në këtë fushë janë në një fazë shumë të hershme dhe sistemi mbikëqyrës i tregut të Kosovës është larg nga praktikat evropiane. Inspektorati i tregut punëson një staf prej 12 zyrtareve. Mungesa e infrastrukturës ligjore, e qasjes strategjike dhe kapacitetit pengojnë zhvillimin e mëtejshëm në këtë sektor.

Kosova ka miratuar legjislacionin për pajisjet e tensionit të ulët, makineritë, instalimet kabllore, sigurinë e lodrave, produkteve të ndërtimit dhe tekstilit.

Ka pasur përparim në fushën e **mbrojtjes së konsumatorit**. Ligji për mbrojtjen e konsumatorit ishte amandamentuar në prill. Janë caktuar shtatë anëtarë e Këshillit për mbrojtjen e konsumatorit, duke përfshirë edhe pesë përfaqësues të OJQ-ve. Dy shoqata për mbrojtje të konsumatorit janë aktive në Kosovë. Megjithatë, kapacitetet administrative të mbeten të pamjaftueshme. Zyra për Mbrojtjen e konsumatorëve brenda Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë ka vetëm një zyrtar të punësuar. Nuk ka strategji për mbrojtjen e konsumatorit. Në përgjithësi, përafrimi me standardet evropiane dhe legjislacionit në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave është i kufizuar. Janë të pamjaftueshme kapacitetet administrative për zbatimin e këtyre standardeve. Përpjekje të konsiderueshme janë ende të nevojshme në këtë drejtim.

4.1.2. Lëvizja e personave, shërbimeve dhe e drejta e themelimit të kompanive

Përparim i kufizuar mund të raportohet në fushën e **lëvizjes së lirë të personave**. Në përputhje me standardet evropiane mbetet ende në një fazë të hershme. Lëvizja e lirë e personave nëpër Kosovë nuk është siguruar plotësisht. Për sa i përket koordinimit të sigurimeve shoqërore, puna ka filluar, por ndarja e resurseve për këtë qëllim duhet të rritet ndjeshëm. Nuk ka përparim në lidhje me lirinë për të ofruar **shërbime**, si dhe miratimi i standardeve evropiane është në një fazë shumë të hershme. Korniza ligjore për sa i përket lirisë për të ofruar shërbime dhe të **drejtën e themelimit** mbetet i pabarabartë. Përputhshmëria me standardet evropiane është e kufizuar. Nuk ka pasur progres në fushën e ligjit për kompani. Në përgjithësi, nuk ka shtrirje të legjislacionit për kompani.

4.1.3. Lëvizja e lirë e kapitalit

Ka pasur një përparim të kufizuar në fushën e **lëvizjes së lirë të kapitalit**. Legjislacioni për shkëmbim të huaj konsiston nga një rregull e Bankës Qendrore që përcakton kufijtë e shumës së valutave të huaja që një bankë mund të ketë si një përqindje e kapitalit të tyre shtesore. Kosova ka një regjim shumë liberal në lidhje me lëvizjet e kapitalit: banka e huaja përfitojnë nga trajtimi i plotë kombëtare, për të menaxhuar rreth 90% të pasurive në sektorin bankar. Të njëjtat rregulla aplikohen për kompanitë vendase dhe të huaja që investojnë në Kosovë. Nuk ka kufizime për të huajt, për marrjen e pasurive të patundshme. Kosova përdor parimet e Bazelit I mbi kërkesat e kapitalit për bankat dhe gradualisht lëviz në drejtim të zbatimit më të plotë të udhëzimeve II të Bazelit.

Ka nevojë për përpjekje për të përshtatur rregulloret financiare me standardet më të mira ndërkombëtare, si dhe për të zbatuar ato. Sa i përket rregullimit dhe mbikëqyrjes së bankave, Kosova aktualisht përdor modelin “CAMEL” dhe gradualisht lëviz në Risk-bazuar në mbikëqyrje. Autoritetet mbikëqyrëse duhet të nënshkruajnë memorandume të mirëkuptimit me mbikëqyrësit e bankave të huaja. Në përgjigje të krizës financiare, Banka Qendrore ka rritur fushën e mbikëqyrjes e saj në sektorin financiar dhe ka luajtur një rol pozitiv në menaxhimin e rreziqeve që lidhen me krizën. Kapacitetet mbikëqyrëse për fusha të ndryshme të të dhënave specifike dhe automatizim i mëtutjeshëm i procesit të raportimit

Në fund të vitit 2008 dhe në fillim të vitit 2009, Banka Qendrore miratoi disa masa për të zhvilluar **sistemin e pagesave**. Një skemë direkte debitore u ngrit. Ajo përfshin marrëveshje operationale dhe procedurat me Korporatën Energetike të Kosovës dhe kompaninë regjionale të ujit të Prishtinës. Infrastruktura e ndër-elektronike e pastrimit të sistemit bankar është përmirësuar, duke bërë të mundur ueb-based aplikimin, unifikimin e fushave të të dhënave të caktuara dhe automatizimin e mëtejshëm të proceseve të raportimit.

Në përgjithësi, regjimi për lëvizjet e kapitalit është shumë liberal, por përpjekje të konsiderueshme janë të nevojshme sa i përket lëvizjes së lirë të kapitalit për të krijuar një kornizë ligjore në përputhje me standardet e BE.

4.1.4. Doganat dhe tatimet

Ka pasur një përparim në fushën e **doganave**. Kodi i Doganës dhe Akcizës u miratua në nëntor, pjesë e doganave në përgjithësi janë në përputhje me standardet evropiane. Doganat e Kosovës u krijuan brenda Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, në dhjetor 2008. Kosova ka miratuar vulat e reja doganore. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për këtë e ka njoftuar Komisionin Evropian dhe partnerët e CEFTA-s. Serbia nuk ka njohur vlefshmërinë e këtyre vulave dhe vë në pyetje përputhshmërinë e tyre me rezolutën 1244/99 pavarësisht premtimeve të marra nga PSSP i OKB-së që konfirmon pajtueshmërinë me Rezolutën 1244. Njësitë anti-kontrabandë kanë filluar të patrullojnë në të gjitha rrugët, me përjashtim të veriut të Kosovës dhe kjo ka ulur kontrabandën. Megjithatë, trenat që vijnë nga Serbia në Kosovë nuk i nënshtrohen kontrolleve doganore ose procedurave tjera.. Mbi 65% e të ardhurave të Kosovës janë nga taksat e mbledhura në kufi. EULEX-i ka filluar regjistrimin e mallrave që hyjnë në

portat 1 dhe 31 në veri të Kosovës, si dhe është bërë pastrimi i terminalit të Mitrovicës. Shkëmbimin e informacionit ndërmjet doganave të Kosovës dhe Serbisë me ndihmën e EULEX-it ka rezultuar në një numër të hetimeve penale në të dyja anët. Të ardhurat e mbledhura nga doganat për periudhën janar-shtator 2009 ishte rreth 380 milion, pra 4,5% më të larta se të ardhurat e mbledhura për të njëjtën periudhë në vitin 2008.

Doganat e Kosovës kanë realizuar një vlerësim të kapaciteteve të saj operative në gusht, kundrejt standardeve të BE-së. Burimet njerëzore dhe menaxhimin e përgjithshëm, infrastruktura, pajisjet dhe pas kontrolleve janë vlerësuar si efektive. Vëmendje të mëtejshme duhet të i përkushtohet eksportit të prodhimeve bujqësore, zbatimit të drejtave të pronësisë intelektuale dhe sigurisë së zinxhirit furnizues. Sistemi IT duhet të zëvendësohet me një sistem më fleksibil dhe të integruar. Sistemi i tanishëm nuk e mbështetë plotësisht përdorimin e Tarifave të Integruara të Kosovës, në veçanti regjistrimin e mallrave transit dhe integrimin e të dhënave të tarifave për vendet e tjera. Në shkurt 2009, është themeluar një njësi për drejtat e pronës intelektuale për të zbatuar rregulloren për themelimin e procedurave doganore për veprime kundër mallrave të falsifikuara, për nevojën për të përmirësuar funksionalizimin e kësaj njësie. Sektori i Inspektimit të Brendshëm në bashkëpunim me Agjencionin Anti-Korrupsion ishte ngritur për të luftuar korrupsionin, që është një shqetësim i doganave. Doganat e Kosovës janë pjesë e Task-Forcës përfshirë Policinë të Kosovës, Zyrën e Prokurorit, Administratën Tatimore dhe Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Doganat e Kosovës merr pjesë në një projekt rajonal për shkëmbimin e paraarritjes së informacionit doganor me vendet fqinje, e cila lehtëson tregtinë dhe zbatimin e legjislacionit doganor. Duhet të fuqizohet më tej fuqia punëtore dhe kapacitetet administrative të Doganave të Kosovës për të zbatuar legjislacionin doganor.

Fushat specifike që duhet të ju kushtohet vëmendje janë lufta kundër kontrabandës dhe falsifikimit, përmirësimi i sistemit të TI të Doganave dhe aftësinë e saj për të mbështetur përdorimin e Tarifës së Integruar të Kosovës. Kontrolli dhe mbikëqyrja duhet të shtrihet në veri të Kosovës.

Në përgjithësi, dispozitat ligjore për dogana janë në pajtueshmëri me standardet evropiane. Megjithatë kapacitetet administrative duhet të përforcohen thellësisht, dhe lufta kundër korrupsionit duhet të intensifikohen.

Ka pasur një përparim në fushën e taksave. Në janar, reforma tatimore ka hyrë në fuqi dhe normat e reja tatimore zbatohen tani. Normat të tatimit mbi të ardhurat personale ulën nga 0%, 5%, 10% dhe 20% respektivisht 0%, 4%, 8% dhe 10%. Tatimi mbi të ardhurat është zvogëluar nga 20% në 10%. TVSH-ja u ngrit nga 15% në 16%, dhe obligimet e akcizës në duhan u rrit nga 17 euro në 21 euro për kilogram. Ligji mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat u miratua në shkurt. Ai fut disa elemente të reja në sistemin e taksave, krijimi i mundësive për Administratën Tatimore të Kosovës për çështjen e numrave të tatimit, dhe krijimin e regjistrave elektronike të mjeteve të gatshme financiare. Ky Ligj gjithashtu i jep autoritet shtesë administratës tatimore për të kapur mallrat që nuk mund të llogariten nëpërmjet transaksioneve të regjistruara dhe pagesat përkatëse nga firma që i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat e korporatës. Numrat e

identifikimit fiskal janë atribuar, dhe çdo biznes i themeluar pas gushtit duhet të zotërojnë një të tillë.

Nuk ka pasur progres në kornizën e legjislacionit në fushën e taksimit të TVSH. Pragu i TVSH-së i regjistrimit mbetet i lartë (50.000 euro qarkullim), e cila e bën që shumë kompani nuk i detyrohen TVSH-së. Një vlerësim i përgjithshëm i administratës tatimore u zhvillua në Gusht për matjen e kapaciteteve operative, kundrejt politikave “blueprint” të BE-së mbi tatimet, arriti në përfundimin së ka nevojë për një strukturë të re organizative për të shmangur rrezikun e dyfishimit dhe së kapacitetet e saj për hetim dhe mashtrim në lidhje me shmangien e taksave duhet të forcohet. Rezultatet e tjera kanë të bëjnë me nevojën për të zhvilluar strategji anti-korrupsion dhe për rritjen e shërbimeve të informacionit të tatimpaguesve. Sistemi i Integruar i Standardizimit i Administratës Tatimore është duke u përmirësuar deri në një sistem të ri operativ TI.

Të hyrat taksave në shtatë muajt e parë të 2009 ishte më e ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2008. Kjo është kryesisht për shkak të reduktimit të normës së tatimit mbi të ardhurat dhe për shkak së, ndryshe nga 2008, nuk është vjelë asnjë shtesë mbi profitin e PTK-së. Administrata Tatimore e Kosovës ka nënshkruar memorandum të mirëkuptimit me Doganat e Kosovës, Policinë dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për të përmirësuar mbledhjen e taksave. Megjithatë Infrastruktura TI mbetet e paefektshme, dhe i mungon kapaciteti për të zbatuar pagimin e taksave dhe për të reduktuar ekonominë informale.

Në përgjithësi, ka pasur një progres legjislativ në fushën e taksave. Megjithatë, legjislacioni duhet të shoqërohet me udhëzime të detajuara administrative dhe përpjekje të mëtejshme për të siguruar zbatimin efektiv. Kosova ka nevojë për të rritur përpjekjet për të zbatuar pagesat e taksave dhe për të reduktuar ekonominë informale.

4.1.5. Konkurrenca

Ka pasur një përparim në fushën e **konkurrencës**. Komisioni i Pavarur i Konkurrencës i Kosovës është themeluar në nëntor 2008 dhe Kuvendi ka emëruar pesë anëtarë të tij. Komisioni është një organ i pavarur që raporton drejtpërdrejt Kuvendit. Komisioni ka qenë funksional që nga marsi dhe ka kryer një rishikim të rregulloreve ekzistuese të konkurrencës, duke ardhur në përfundim së një ligj i ri është i nevojshëm për të lidhur praktikën e konkurrencës në Kosovë me standardet evropiane. Megjithatë, Komisioni është i penguar nga mungesa e burimeve njerëzore, veçanërisht në lidhje me punësimin e personelit të kualifikuar.

Duke pasur parasysh **politikën e konkurrencës**, Komisioni ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me oden ekonomike, ministritë e tregtisë dhe industrisë dhe të financave, si dhe me zyrë e doganave. Komisioni ka hetuar disa të dyshuar për shkelje të rregullave të konkurrencës. Komisioni ka ndërhyrë që të bëjë një marrëveshje midis furrave mbi çmimin e bukës. Komisioni është bërë anëtar i plotë i Rrjetit Ndërkombëtar të Konkurrencës. Nuk ka pasur asnjë përparim lidhur me ndihmën e shtetit, dhe nuk ka ligj mbi **ndihmën shtetërore**,

Pavarësisht përparimit në zbatimin e politikës së konkurrencës, zbatimi i përgjithshëm i politikës së konkurrencës në Kosovë është në një fazë të hershme. Kapacitetet administrative duhet të forcohet. Ekziston një nevojë për rritjen e ndërgjegjësimit të sektorit privat me rregullat e konkurrencës. Harmonizimi i ndihmave të shtetit duhet të fillojë

4.1.6. Prokurimi Publik

Për sa i përket prokurimit situata është keqësuar në krahasim me vitin e kaluar, përveç disa përmirësimeve në kornizën ligjore. Implementimi i legjislacionit për ligjin e **Prokurimit Publik** është kompletuar në janar. Sidoqoftë, ligji i Prokurimit Publik nuk është në përputhje me standardet evropiane të prokurimit. Një numër i dispozitave të pa implementuara mbeten direktivat e KE, por jo më pak regjim më fleksibil në sektorin e shërbimeve. Zbatimi i ligjit në praktikë shkakton shqetësime serioze.

Fokusi kryesor i Komisionit Rregullativ për Prokurimin Publik është monitorimi, mbikëqyrja dhe interpretimi ligjor. Sidoqoftë, monitorimi është bërë kryesisht në rastet kur kontratat kanë qenë të nënshkruara paraprakisht dhe nuk përfshinë fazën e tyre të implementimit. Deri me tani, asnjë udhërrëfyes nuk u është siguruar autoriteteve kontraktuese. Komisioni ka nevojë të forcojë udhërrëfyesin dhe rolin përkrahës dhe këshillëdhënës. Për këtë shkak në shtator është krijuar në funksion një tryeze ndihmese.

Që nga maji 2009, Trupi Mbikëqyrës i Prokurimit ka shqyrtuar 290 ankesa. Sidoqoftë, nuk ka ndonjë publikim sistematik të vendimeve të tij dhe kjo shpeshherë ka mungesë të argumenteve ligjore.

Agjensioni Publik i Prokurimit është autoriteti ekzekutiv kryesor, por roli i tij qendror si trup posedues është dobësuar nga mos vazhdimësia e shfrytëzimit të prokurimit qendror duke përfshirë edhe kornizën e marrëveshjes. Kapaciteti administrativ është dobësuar nga përfitimi i madh në mes të zyrtareve të prokurimit në dy nivelet qendrore dhe lokale.

Zyrtaret e prokurimit në Kosovë mbeten akoma të penguar dhe të frikësuar. Ky fakt ka një ndikim negativ në kualitetin e prokurimit publik.

Trajnimi dhe certifikimi i zyrtareve të prokurimit është i pamjaftueshëm edhe është vonuar në vitin 2009. Ligji kërkon që secili zyrtar i lartë i prokurimit të ndjek së paku dhjetë dite trajnime të rregullta për çdo vit. Sistemi ekzistues i certifikimi kërkon që të paktën një herë të kryhet kursi, i cili nuk është në pajtueshmëri me ligjin aktual.

Vlera e kontratave të dhëna përmes prokurimit publik është rritur, duke prezantuar gati 20% të GDP-së në Kosovë. Sidoqoftë, proporcioni i lartë i tenderëve të anuluar për shkak të mos-përputhshmërisë me kërkesat administrative dhe përzgjedhjes së metodave të prokurimit jep arsye për t'u brengosur.

Procedurat e hapura llogaritet të jene 77% të vlerës totale për kontratat e nënshkruara dhe për procedurat e negociimit për 20% me tepër dhe procedurat tjera duke u shfrytëzuar në mënyre shumë më të kufizuar. Përdorimi i tenderimit me një burim është rritur prej 50 Milion deri në 164 Milion Euro.

Qeveria ka adoptuar pakon e kompletuar ligjore kundër korrupsionit. Sidoqoftë, ka pasur një numër shumë të kufizuar të hulumtimeve të rasteve ilegale të korrupsionit, kurse rezultati i tyre tregon se ka nevojë të ketë një metodë dhe mjete më të sofistikuara të hulumtimit. Rendësi më e theksuar ka nevojë të vendoset në monitorimin dhe implementimin e kontratave të prokurimit. Kapaciteti administrativ dhe mekanizmi i koordinimit të përfituesve kryesorë të sistemit të prokurimit publik ka nevojë akoma për përforsim, në veçanti për ta reduktuar mundësinë për korrupsion.

Në përgjithësi, përveç disa rezultateve që janë arritur në adoptimin e legjislacionit dhe themelimin e Trupit Mbikëqyrës të Prokurimit, ka një numër të madh të brengave të zhvillimit për sa i përket implementimit të prokurimit publik të Kosovës.

4.1.7 E drejta e Pronësisë Intelektuale

Ka qene një progres shume i kufizuar në fushën e **Drejtës së Pronësisë Intelektuale**.

Pak progres mund të raportohet për sa i përket kapaciteteve administrative në fushën e **Drejtës së Pronësisë Industriale**.

Njësia Qendrore e të Drejtës për Pronësinë Intelektuale është krijuar si pjesë Doganave të Kosovës në muajin shkurt. Ky njësit ka për qëllim për të siguruar koordinimin në mes të autoriteteve doganore, inspektoratit të tregut, policisë dhe zyrave të prokurorisë për të implementuar rregulloren 2008 të themelimit të procedurave doganore për aksionin kundër të mirave të falsifikuara, të mirave të vjedhura dhe të mirave të cilat shkelin të drejtat pronësore intelektuale.

Zyra për Pronat Industriale është një institucion i pavarur përgjegjës për implementimin e ligjeve mbi të drejtën ligjore, markën tregtare dhe dizajnin industrial. Zyra ka pranuar 18.000 aplikacione që nga shtatori 2008, kryesisht për markën tregtare.

S'ka pasur asnjë progres për sa i përket të **drejtës autoriale dhe të drejtave që lidhen me të**. Ligji mbi të Drejtën Intelektuale nuk është rregulluar akoma. Legjislacioni për implementimin e ligjit mbi të drejtën ligjore dhe të drejta që lidhen me të nuk është adoptuar akoma. Kapaciteti i zyrës koordinuese, e emëruar si Zyra për Integritet Evropiane në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve është shume e kufizuar.

Zbatimi i të Drejtave Pronësore Intelektuale mbetet mjaft i dobët. Nivel i lartë falsifikimit dhe të piraterisë qëndron akoma. Kapaciteti administrativ për të implementuar të drejtën intelektuale dhe industriale mbetet i pamjaftueshëm dhe implementimi i provizioneve mbetet akoma si nevojë.

Përgjegjësitë e trupave të ndryshëm që merren me fuqizimin, gjithashtu edhe divizionit të përgjegjësive ndërmjet tyre, nuk janë të definuar qartë. Nuk pa pasur asnjë progres për sa i përket të drejtës ligjore dhe të drejtave në lidhje me të. Strategjia 2008-2013 e të Drejtës për Pronësi Intelektuale nuk është adoptuar. Drafti aktual përfshinë kryesisht elementet pronësore, me një referim shume të vogël për të drejtën ligjore.

Në përgjithësi, elementet kyçe të legjislacionit të së drejtës pronësore industriale janë në përmirësim dhe është arritur progres për sa i përket kapacitetit administrativ. Sidoqoftë, nevojitet përkushtim me i madh në këtë aspekt. Përgatitjet e Kosovës në fushën e të Drejtës së Pronës Intelektuale mbeten akoma në fazën fillestare. Provizioni ligjor për të drejtën ligjore dhe të drejtat në lidhje me të nuk janë akoma në fuqi dhe kapacitetet për implementim janë mjaft të kufizuara. Në këtë fushë akoma mungon një strategji gjithëpërfshirëse.

4.1.8. Punësimi dhe Politikat Sociale

Në Kosovë nuk ka ligj të punës dhe nuk ka gjykata të specializuara për çështjet e punës. Legjislacioni në fushën e shëndetit dhe sigurisë në punë është jo adekuat. Inspektorati i Punës ka kapacitete të kufizuara për të implementuar Ligjin mbi Sigurinë, Shëndetin në Punë dhe Ambientin e Punës. Inspektorati i punës nuk ka bazë të të dhënave për kontrollimin shëndetësor të të punësuarve apo për numrin e të punësuarve në sektorin privat. Nuk të dhëna statistikore për numrin e gjobave të shqiptuara nga Inspektorati; ndodhë shpesh që gjobat të mos paguhen. Mungesa e pajisjeve teknike pengon punën e Inspektoratit të punës.

Është bërë progres minimal në fushën e dialogut social. 35 sindikata sektoriale dhe 5 shoqata janë të regjistruara në Kosovë. Këshilli Trepalësh Konsultativ është ri emëruar si Këshilli Ekonomiko Social dhe ka realizuar takimin e parë në korrik. Roli i partnerëve social në vendimmarrje është i limituar. Kontrata Kolektive e cila është nënshkruar në vitin 2004 për pagat minimale, ende nuk është duke u implementuar. Ligji për sindikatat është miratuar në Gusht; nuk ka ligj për grevat. Punonjësit shëndetësor, punonjësit gjyqësor dhe punonjësit në Korporatën Energjetike të Kosovës kanë hyrë në grevë gjatë periudhës raportuese. Gjithashtu është mbajtur edhe një grevë e organizuar nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës.

Në fushën e përfshirjes sociale, Kosova ka miratuar një plan veprimi për personat me aftësi të kufizuara në muajin prill. Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale kanë ofruar shërbime të përkujdesjes shtëpiake për persona të prekur nga çrregullimet mendore dhe psikiatrike. Nën autoritetin e Ministrisë së Shëndetësisë janë hapur nëntë shtëpi të komunitetit për shëndet mendor dhe shtatë shtëpi rezidente. Në shtator të këtij viti, Kosova ka filluar një fushatë promovuese për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara. Megjithatë, rehabilitimi i personave me aftësi të kufizuara fizike vazhdon të menaxhohet vetëm nga OJQ-të. Ka mungesë të objekteve rehabilituese. Mos pasja qasje në ndërtesat dhe shërbimet publike për personat me aftësi të kufizuara është një çështje me të vërtetë shqetësuese.

Në fushën e kundër diskriminimit, miratimi i strategjisë dhe planit të veprimit mbi të drejtat e njeriut 2009-2011 ka futur në fuqi kornizën ligjore (Shih gjithashtu pjesën 2.2. – Të drejtat e njeriut mbrojtja e minoriteteve). Megjithatë, qeveria nuk ka ndërmarrë veprime konkrete për të promovuar respektimin e të drejtave të komunitetit LGBT (komuniteti i lesbikeve, homoseksualëve, biseksualëve dhe trans-seksualëve).

Sa i përket mbrojtjes sociale, skema e ndihmës sociale është duke u rishikuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Rreth 325 000 persona (përafërsisht 15% e popullsisë së Kosovës) marrin përfitime sociale ose pensione, ndikimi i të cilave në uljen e varfërisë monitorohet dobët. Mungesa e të dhënave të besueshme statistikore mbi çështjet e punësimit, pengon veprimet efektive për të luftuar shkeljet e mundshme ligjore. Legjislacioni në fushën e shërbimeve sociale dhe përkujdesjes institucionale kërkon miratimin e akteve nënligjore për të implementuar decentralizimin e shërbimeve sociale në komuna. Kosova nuk ka ligj për sigurimin shëndetësor dhe as fond të sigurimit shëndetësor.

Programi për zhvillimin e politikave të qëndrueshme të **punësimit** është miratuar nga partnerët lokal dhe ndërkombëtarë në korrik të këtij viti. Ky program parasheh buxhet direkt për tri vitet e ardhshme për një numër të **politikave** fundamentale, duke përfshirë ambientin makroekonomik, klimën investuese, politikat e tregut të punës, politikat e aftësisë dhe mbrojtjes sociale. Është krijuar komiteti ndërministror për punësim i udhëhequr nga Zëvendës Kryeministri qëllimi i të cilit është koordinimi mes agjencive relevante. Ligji për Aftësimin dhe Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara është miratuar në dhjetor të vitit 2008.

Megjithatë, autoritetet duhet të miratojnë një strategji të punësimit. Papunësia e regjistruar vlerësohet të jetë 43% e popullsisë ekonomikisht aktive. Mbi 338 000 persona janë regjistruar si të papunë në fund të qershorit 2009. Mbi 90% e punëkërkuessve të regjistruar janë të papunësuar të regjistruar për më shumë se 12 muaj.

Personat me aftësi të kufizuara mbesin në mesin e grupit në gjendje më të pafavorshme, së bashku me komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Punësimi i femrave mbetet shumë i ulët (55%) dhe papunësia e të rinjve është mjaft e lartë. Implementimi i planit të veprimit për punësimin e rinisë pengohet nga mungesa e koordinimit ndër-institucional. Kapaciteti administrativ i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale është i ulët.

Në fushën e **shëndetit publik**, Ligji për Shëndetësi është amandamentuar në dhjetor, i cili ka rregulluar decentralizimin e disa shërbimeve mjekësore. Megjithatë, ministria mbetet të finalizoj strategjinë shëndetësore 2009-2014. Fusha e shëndetit mendor ka nevojë të forcohet, posaçërisht kur bëhet fjalë për fëmijët dhe rininë. Përqindjet e vdekjeve gjatë lindjes dhe paranatale janë të larta krahasuar me rajonin, mirëpo paraqet një rënie të vogël. Përqindja e vdekjes së foshnjave konsiderohet të jetë më e larta në Evropë. Keq ushqyeshmëria kronike është një çështje shqetësuese. Deri më tani janë licencuar 563 ofrues privat shëndetësorë. Infrastruktura shëndetësore, duke përfshirë pajisjet mjekësore, furnizimin me barna dhe kapacitetet spitalore, janë të një niveli të dobët. Objektet spitalore dhe ato të përkujdesjes parësore janë të vjetruara. Në përgjithësi,

sektori shëndetësor është në një nivel të dobët dhe kërkon urgjentisht vëmendjen e autoriteteve.

Në përgjithësi mund të raportohet progres i kufizuar në sektorin e punësimit dhe shëndetit publik. Mungesa e kornizës adekuate ligjore dhe kapaciteteve të dobëta administrative paraqesin pengesë serioze për zhvillimin e politikave efektive të punësimit. Duhet të ngritën kapacitetet administrative dhe institucionale në sektorin e shëndetit publik.

4.1.9. Arsimi dhe hulumtimi

Arsimi është sektor me prioritet në Kornizën Afat-mesme të Shpenzimeve. Për të gjithë nxënësit e shkollave fillore janë shpërndarë falas tekstet shkollore esenciale. Gjatë periudhës raportuese janë ndërtuar 45 shkolla. Shkollat do të operojnë me më së shumti dy ndërrime që nga shtatori i këtij viti. Është krijuar Këshilli për Licencimin e Mësimdhënësve. Fondi për pagat e mësimdhënësve është rritur në vitin 2009 për 4.5 milion Euro. Kosova ka konsoliduar pjesëmarrjen e saj në programet e BE-së; në programin Tempus dhe Erasmus Mundus. Kjo ka rezultuar edhe me hapjen e zyrës së Tempusit në Universitetin në gjuhën serbe në Mitrovicën veriore, ku Universiteti ka pasur mundësinë të aplikoj për grantet e Tempusit. Këshilli Kosovar për Plan programe është funksional.

Agjencioni Kosovar për Akreditim dhe bordi i tij janë funksional. Procesi i akreditimit të ofruesve të arsimit të lartë publik dhe privat ka përfunduar në maj të këtij viti me ndihmën e ekspertëve ndërkombëtarë. Agjencioni gjithashtu ka konfirmuar akreditimin institucional të Universitetit të Prishtinës dhe të disa kolegjeve private. UP ka zgjedhur rektorin e ri në korrik të këtij viti. Universiteti i Mitrovicës ka ri zgjedhur rektorin edhe për një mandat në maj të këtij viti. Është krijuar Këshilli për Arsimin e Lartë. Ligji për Arsimin e Lartë është duke u rishikuar me ndihmën e Komisionit Evropian dhe Këshillin e Evropës. Autoriteti i Kualifikimeve Kombëtare është në krijim e sipër i cili do të mbikëqyr kualifikimet kombëtare së bashku me Agjencionin për Akreditim dhe partnerët e tjerë relevant. Në veçanti do të ketë përgjegjësinë për kualifikimet profesionale.

Ka filluar reformimi i Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (AAP), përfshirë rishikimin e programeve mësimore dhe themelimin e qendrave të kompetencës. Ca përparim mund të raportohet përkitazi me bashkëpunimin ndërministror mes Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrisë së Tregtisë, Industrisë dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Një qasje më e orientuar kah tregu i punës në shkollat profesionale është vërejtur dhe së bashkëpunimi mes shkollave AAP dhe sektorit privat është forcuar.

Megjithatë, legjislacioni që rregullon akreditimin kërkon ndryshime. Rolet përkatëse të Agjencisë së Akreditimeve dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë duhet të përshtaten për të siguruar pavarësinë e akreditimit të bartësve të arsimit të lartë. Ka pasur kritika publike për mungesën e transparencën nga ana e ministrisë gjate procesit të akreditimit të ofruesve të arsimit të lartë. Mungesa e akreditimit të ofruesve të AAP-së minon besueshmërinë në skemën certifikuese të AAP-së.

Sistemi arsimor në Kosovë vazhdon të ndikohet nga mungesa e burimeve, mungesa e objekteve adekuate (duke përfshirë shërbimet bazike sanitare dhe mos pasja qasje në ujë të pijshëm), kualiteti i dobët i mësimdhënies dhe niveli i ulët i regjistrimit në sistemin shkollor (më i ulët së mesatarja e rajonit). Implementimi i Ligjit për Arsim pengohet në nivelin lokal për shkak të mungesës së kapaciteteve të duhura financiare dhe administrative në drejtoritë komunale të arsimit. Përqindja e lënies së shkollimit është më e lartë së në rajon dhe mungesa apo vonesa e mësimdhënësve është një çështje shqetësuese. Pjesëmarrja apo përfshirja në zhvillimin e fëmijërisë së hershme jo të detyruar dhe në arsimin e lartë e aftësim, është ndër më të ulëtat në Evropë. Ende mungon një mekanizëm për monitorimin e kualitetit të mësimdhënies.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ende nuk ka hartuar plan programet për komunitetet rome, ashkalinje, egjiptiane dhe gorane. Ministria ka alokuar fonde minimale për projekte të investimeve kapitale nga të cilat përfiton komuniteti serb.

Fusha **kërkimore** aktualisht është prioritet në këtë sektor. Në prill të këtij viti, MASHT-i ka emëruar koordinatorin për Programin e 7 në Kornizë. Këshilli për Shkencën ka hartuar planin e veprimit për vitin 2009, mirëpo implementimi i tij ka ngecur për shkak të burimeve të kufizuara. Kapacitetet kërkimore dhe zhvillimore brenda Universitetit të Prishtinës janë forcuar.

Në përgjithësi, mund të raportohet progres në sektorin e arsimit dhe shkencës. Megjithatë, duhet të intensifikohet procesi i reformimit institucional dhe ligjor, të koordinohet më mirë dhe të transferohet në praktikë në mënyrë më efektive. Duhet të forcohen në masë të theksuar kapacitetet qendrore dhe lokale të mësimdhënies dhe menaxhimit arsimor. Gjithashtu duhet të bëhen përpjekje të theksuara për të rritur pjesëmarrjen ose përfshirjen në edukim. Duhet të krijohet një sistem për monitorimin e kualitetit të edukimit. Nevojiten burime shtesë për qëllime kërkimore.

4.1.10 Çështje që lidhen me OBT

Kosova nuk është anëtare e OBT dhe nuk ka ndërmarrë ndonjë hap zyrtar për t'u anëtarësuar në OBT(WTO).

4.2. Politikat sektoriale

4.2.1. Industria dhe NVM-të

Progres i kufizuar është arritur në fushën e **Industrisë dhe NVM-ve**. Në prill, Parlamenti ka adoptuar Ligjin për Zonat Ekonomike, që ka për qëllim stimulimin e zhvillimit të sektorit privat me theks të veçantë në zhvillimin e NVM-ve. Ai udhëheq themelimin, operacionalizimin dhe mbikëqyrjen e zonave ekonomike.

Sa i përket mjedisit biznesor, one-stop-shop dhe regjistrimi on-line dhe shërbimet e licencim të ofruara nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve akoma nuk janë tërësisht

funkzionale. 25 kompani, duke përfshirë katër kompani ndërkombëtare, kanë aplikuar për prona në parkun e biznesit në Drenas. Puna rreth infrastrukturës së këtij projekti pothuajse ka përfunduar.

Në pajtim me Kartën Evropiane për Biznese të Vogla, Kosova ka filluar implementimin e strategjisë për mësimin e ndërmarrësisë. Elementet nën implementim e sipër përfshijnë trajnimet e mësuesve dhe reformave të planit mësimor. Më shumë duhet të bëhet për të krijuar bashkëpunim strukturor dhe për të lidhur bizneset lokale me shkollat.

Nuk ka strukturë strategjike për zhvillimin e **NVM-ve** në Kosovë për të drejtuar aktivitetet e Agjencisë Mbështetëse të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Kapacitetet administrative të kësaj agjencie janë të kufizuara. Aplikimet online nuk janë tërësisht funksionale. Këshilli Konsultativ i NVM-ve, që përfaqëson institucionet qeveritare dhe ato joqeveritare, ka filluar së funksionuari prapë, pas një pezullimi në vitin 2008.

Agjencia Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve, zyrtarisht është hapur në vitin 2002, dhe vazhdon të regjistroj biznese. Regjistrimi i bizneseve përfshinë 93,000 kompani; mirëpo, vetëm 10% e tyre janë aktive. Tarifat për hapjen dhe mbylljen e një biznesi janë më të vogla në regjion (€5-20). Informimi në lidhje me kompanitë e regjistruara bëhet i mundur në mënyrë elektronike (online). Nuk ka ligj për nënshkrim elektronik (e-signature). Kjo pengon zhvillimin e regjistrimit elektronik të kompanive. Në përgjithësi struktura legale dhe institucionale për NVM-të dhe politikat industrial ka nevojë për zhvillim të mëtutjeshëm. Momentalisht, Kosova kryesisht varet nga masat ad hoc dhe pilot projektet.

4.2.2. Bujqësia dhe peshkataria

Ligji për **bujqësi dhe zhvillim rural** që adoptuar në korrik. Ai siguron një kornizë për praktikën e zhvillimit rural dhe bujqësor në Kosovë dhe krijon bazën ligjore për azhurnimin e planit për zhvillim rural dhe bujqësor për periudhën 2009-2013 dhe planit shoqëruar të veprimit. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural i ka përsheptuar përpjekjet e saj për reforma në fushat sikurse konsolidimi dhe rehabilitimi i tokës bujqësore, përmirësimi i menaxhimit të burimeve natyrore në zonat rurale, rritja e konkurrencës dhe diversifikimit të fermave dhe rritja e cilësisë së ushqimit. Këto përpjekje janë mbështetur nga një rritje prej 40% në shpenzimet qeveritare për sektorin e bujqësisë në 2009-ën krahasuar me 2008-ën. Po ashtu është planifikuar një sistem i granteve, kryesisht për të mbështetur masat strukturore reformuese më tepër sesa për të ofruar pagesa direkte për prodhimin.

Ligji për bujqësinë organike duhet të amendamentohet në pajtim me ndryshimet e bëra në rregulloret e BE-së për bujqësinë organike. Legjislacioni vijues për implementimin e ligjit për verëra nuk është adoptuar. Kjo ka çuar në vonesa në reformimin e fushave të rëndësishme sikurse cilësia e kontrollit dhe standardet e etiketimit.

Ligji për pyjet duhet të rishikohet në mënyrë që të forcohen masat mbrojtëse kundër dëmtimit dhe prerjeve ilegale të pyjeve dhe shkeljeve të lejeve për prerje. Përgjegjësitë për menaxhimin e pyjeve do të transferohen tek niveli komunal ashtu siç është paraparë

në planet për decentralizim të Kosovës. Sfida kryesore në ruajtjen e pyjeve të Kosovës, që mbulon 42% të hapësirës së saj, është kapaciteti i kufizuar i autoriteteve për implementimin e ligjit. Nevojitet koordinim më i mirë në mes të institucioneve.

Bujqësia kosovare vazhdon të pësojë nga zotërimet e ngastrave të vogla, kontrolli i dobët i shfrytëzimit të tokave pjellore për ndërtim, vlerësimi dhe përcaktimi i çmimit të tokave bujqësore (si për shitje ashtu edhe për qiradhënie), vështirësitë për fermerët që të marrin kredi dhe një sistem i vjetërsuar dhe joadekuat i regjistrimit të tokave.

Në mars, Kuvendi adoptoi ligjin për ushqimin që siguroi themelimin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë. Agjencia është duke funksionuar nën autoritetin e Zyrës së Kryeministrit dhe ka për detyrë të koordinojë aktivitetet në sferën e sigurisë ushqimore. Ligji krijon një ndarje të qartë të përgjegjësive në mes të shërbimeve të ndryshme në sektorin bujqësor. Ai transferon përgjegjësitë nga niveli komunal tek ai qendror.

Në sferën e **veterinarisë dhe fito-sanitarisë**, ligji i ri për ushqimin siguron një bazë për adoptimin e legjislacionit implementues. Në këtë aspekt mund të raportohet progres i kufizuar. Planet për të vlerësuar dhe ngritur ndërmarrjet agro-ushqimore mbeten në fazën përgatitore. Tri thertore të reja janë licencuar gjatë periudhës raportuese. Nuk ka objekte për përpunimin e produkteve të mbetura të kafshëve në Kosovë. Megjithëse ekziston korniza e nevojshme ligjore, sistemi i identifikimit, regjistrimit dhe kontrollit të lëvizjes së kafshëve në Kosovë nuk është funksional.

Në prill, është adoptuar një udhëzim administrativ për përcaktimin e regjioneve të **peshkatarisë** në Kosovë. Ai lejon peshkatarinë sportive/rekreacionale dhe peshkatarinë ekonomike. Shumica e standardeve evropiane për peshkatarinë nuk vlejnjë për Kosovën, e cila nuk ka peshkim në det të thellë.

Në përgjithësi, është zhvilluar korniza ligjore e bujqësisë, veterinarisë dhe fito-sanitare. Mungesa e kapaciteteve administrative mbetet shqetësuese, duke çuar në vonesa për reformimin e sektorit bujqësor. Ka pasur progres të kufizuar në përshtatjen me standardet evropiane.

4.2.3. Mjedisi

Mund të raportohet për progres të arritur në fushën e **legjislacionit horizontal**. Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor janë aprovuar në muajin mars, por që të dy kanë nevojë të rishikohen për t'u ofruar me standardet evropiane. Është implementuar një numër i vogël i projekteve të parapara në Planin e Kosovës për Veprim në Mjedis.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka siguruar pajisjet mobile për monitorimin e **cilësisë së ajrit**. Megjithatë ende nuk ka strategji për cilësinë e ajrit dhe nuk ka ndarje të qarta të përgjegjësive sa i përket menaxhimit të sistemit për monitorimin e cilësisë së jarit. Nuk mund të raportohet për progres në sektorin e menaxhimit të mbeturinave. Sipas Traktatit të Komunitetit për Energji, Kosova duhet të implementojë

Direktivën për Impiantet me Djegie të Madhe, por nuk është bërë përpjekje për ndërrimin e dispozitave të kësaj direktive. Mbetet e ulët shkalla e grumbullimit të faturave nga kompanitë për ujë dhe mbeturina.

Progres i kufizuar është arritur në fushën e **cilësisë së ujit**. Ligji për Ndërmarrjet Publike i përcakton përgjegjësit për operimin dhe mirëmbajtjen e ndërmarrjeve dhe aseteve publike në sektorin ujërave. Megjithatë, nuk ka impiante për trajtimin e ujërave. Vetëm 70% e popullsisë është e kyçur në sistemin e ujit të pijes, dhe vetëm një e treta në sistemin e kanalizimit. Sa i përket themelimit të Autoriteteve të Pellgjeve Lumore të paraparë me Ligjin e Ujërave nuk ka progres. Struktura e tyre ende nuk është definuar dhe nuk janë siguruar burimet njerëzore dhe financiare. Funkcionet e tyre janë kryer nga Njësia e Ministrisë për Koordinimin e Pellgjeve Lumore. Çështja e pronësisë së aseteve mbetet e paqartë. Nuk janë ndarë qartë përgjegjësitë e menaxhimit të pendëve. Siguria e infrastrukturës së gjerë, siç janë pendët, digat dhe kapacitetet e ujit kërkon menaxhim dhe monitorim të duhur.

Nuk ka progres në adoptimin e standardeve evropiane në fushën e **mbrojtjes së natyrës**. Transpozimi i Direktivës së Zogjve dhe Habitave janë shtyrë për shkak të vonesave në aprovimin e Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës.

Pak progres mund të shënohet në fushën e **kontrollit të ndotjes industriale**, me aprovimin e Ligjit për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes në muajin mars. Nuk ka progres në fushën e **kemikaleve** ose **organizmave të modifikuar gjenetikisht**. Në fushën e **zhurmës** janë aprovuar disa udhëzime administrative për implementimin e ligjit për Mbrojtje nga Zhurma. Janë bërë disa përpjekje për ngritjen e vetëdijesimit të publikut për çështjet mjedisore. Kjo çështje duhet të përforcohet. Gjithashtu duhet të fuqizohet bashkëpunimi i Ministrisë me OJQ-të mjedisore.

Kosova ka bërë përpjekje për përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve, në veçanti sa i përket pozitës së Agjencisë së Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit. Megjithatë duhet të përmirësohet bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë dhe Institutit Hidrometeorologjik. Strukturat administrative përgjegjëse për sektorin e mjedisit vazhdojnë të vuajnë nga mungesa e burimeve: buxheti i Ministrisë është më i ulëti nga të gjitha ministrat në Kosovë. Mungesa e stafit e bën të vështirë që këto organe të kryejnë përgjegjësitë e tyre. Ndonëse disa nga detyrat e tyre u janë transferuar nivelit lokal, komunat në të shumtën e rasteve kanë mungesë të zyrtarëve dhe inspektorëve mjedisor.

Marrë në përgjithësi, Kosova është në fazën fillestare të bashkimit me standardet Evropiane mjedisore. Mund të raportohet për progres në fushën e mjedisit, në veçanti sa i përket aprovimit të legjislatcionit. Nevojiten përpjekje të më tepërta për të themeluar një infrastruktura institucionale dhe administrative më efektive në këtë fushë. Mbetet i limituar kapaciteti i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe institucioneve tjera relevante.

4.2.4. Politika e transportit

Ka pasur pak progres në rrjetin trans- Evropian të Transportit. Kosova ka vazhduar të marrë pjesë në mënyrë aktive në implementimin e memorandumit të mirëkuptimit të vitit 2004 mbi zhvillimet e SEETO (Evropës juglindore në rrjetin e transportit regjional), veçanërisht përmes përditësimit dhe implementimit të planit shumëvjeçar 2009-2013. Ligji mbi eksproprijimin apo shpronësimin e pronës së paluajtshme, i adoptuar në prill vuri bazën ligjore për Ministrinë e Transportit dhe Post Telekomunikacionit që të kujdeset për shpronësimin e tokës dhe aktivitetet përmes të cilave financohen projektet e infrastrukturës së transportit.

Në fushën e transportit rrugor ka pasur pak progres në ndërtimin e kapaciteteve të Njesisë Planifikuese të Transportit brenda Ministrinë. Sidoqoftë Ministria është së tepërmi e angazhuar në çështjet e menaxhimit ditor të rrugëve në vend të përqendrimit në strategji dhe politika zhvillimore.

Riorganizimit të departamentit të infrastrukturës rrugore duhet të adresohet në mënyrë që të sigurojë një destinim të pastër midis mirëmbajtjes dhe mbikëqyrjes dhe zhvillimit të rrjetit rrugor. Kapacitetet e Departamentit të infrastrukturës rrugore Brenda Ministrinë janë të kufizuara. Vetëm pese komuna kane departamente rrugore.

Këshilli për sigurinë rrugore (i drejtuar nga ministria e transportit dhe post-telekomunikacionit) është themeluar në tetor 2008 kurse sekretariati I tij u bë funksional në janar. Një instruksion administrativ mbi teknikat e inspektimit ishte lëshuar në dhjetor si pjesë e implementimit të ligjit për siguri në rrugë. Plani aksional për sigurinë në rrugë është akoma në pritje. Kapaciteti I inspektoratit të transportit nevojitet të forcohet.

Progres shumë i limituar mund të raportohet në sektorin e **transportit hekurudhor**. Ligji mbi hekurudhat ofron baze ligjore për themelimin e autoritetit rregullativ hekurudhor të pavarur nga ministria. Agjencia e cila është një institucion esencial sa i përket qasjes së palës së tretë në infrastrukturës hekurudhore akoma nuk është themeluar. Ligji mbi Hekurudhat e Kosovës parasheh ndarjen e menaxhmentit të Infrastrukturës operimeve me tren. (Infrastrukturën e Hekurudhave të Kosovës SHA dhe Operimet me trena të hekurudhave të Kosovës SHA)kjo ende nuk është arritur. Kompensimet ofruar hekurudhave për provizion të shërbimeve publike për pasagjer janë dhënë, por kjo nuk mbulon shpenzimet. Transporti hekurudhor nuk është prioritet i Qeverisë. Për këtë sektor janë alokuar burime të kufizuara. Kushtet e infrastrukturës hekurudhore dhe inventarit hekurudhor në Kosovë niveli i shërbimeve hekurudhore mbeten të mangëta. Në kontrast me këtë, strategjia multimodale e transportit në Kosovë identifikon si nevoja për investim për Infrastrukturën hekurudhore të Kosovës mbi 500 Mil. Euro dhe 230 Mil. Euro tjera për Inventarin Hekurudhor për 20 vitet e ardhshme.

Nuk ka asgjë për të raportuar mbi **Transportin Detar** dhe **kanalet e lundrueshme**. Strategjia **Multimodale** dhe Plani i veprimit ende nuk janë adaptuar. Në fushën e **transportit ajror** mund të vërehet progres i pamjaftueshëm. Autoriteti i Aviacionit Civil mori përgjegjësit nga Rregullatori i Mëparshëm i Aviacionit në Janar të 2009. Anëtarët e Bordit të tij janë emëruar në Korrik mirëpo Bordi ende nuk është funksional. Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës i është lëshuar certifikata Aeroporteve standarde (Standard Airodrom Certification) nga Autoriteti Islandez i Aviacionit Civil në Dhjetor të 2008.

Qeveria ka punësuar një këshilltar për transaksion për përgatitjen e dhënies me Koncesion të Aeroportit të Prishtinës.

Është arritur të transponohet një vëllimi substancial i legjislacionit të dal nga marrëveshja për hapësirën e përbashkët Ajrore Evropiane (ECAA). Megjithatë rregullorja e vitit 2009 mbi autorizimin e fluturimeve qarter, vendimi i Qeverisë mbi kategorizimin e aeroportit dhe praktikën e ndarjes së linjave janë jo kompatible me standardet evropiane dhe me obligimet e Kosovës në baze të Marrëveshjes ECAA. Licencat e fluturimit për edhe nga Prishtina jepen në një mënyrë jotransparente dhe me vonesa të pajustificueshme. Në fushën e menaxhmentit të trafikut ajror Kosova duhet të sigurojë së licencat e kontrolluesve të trafikut ajror janë në pajtim me rregullat dhe procedurat e COMMUNITY SINGLE SKY.

Në përgjithësi ka pasur progres në fushën e transportit rrugor. Sidoqoftë ka pasuar disa zhvillime shqetësuese në fushën e Aviacionit. Infrastruktura e Transportit në Kosovë mbetet e mangët dhe e pa zhvilluar. Duhet forcuar kapacitetet në këtë fushë sikurse edhe korniza Ligjore për Partneritetet Publiko Private.

4.2.5. Energjia

Sa i përket **sigurisë së furnizimit me energji** ende nuk ka strategji për **rezerva të naftës**. Në korrik (më vonë së që është paraparë) qeveria vendosi që të iu ofron investitorëve paketën e termocentralit “Kosova e re” dhe minierën e re. Termocentrali duhet të respektojë standardet evropiane për projektet e reja gjeneruese. 2 nga 4 investitorët e mundshëm final kanë tërhequr interesimin e tyre. Njësitë e mbetura operacionale të Kosovës A duhet të shuhet deri në 2017, në mënyrë që të jetë në përputhje me direktivën Large Combustion Plant. Duke pasur parasysh shpenzimin e burimeve ekzistuese të linjës, vonesat në zhvillimin e termocentralit “Kosova e re” dhe renovimin e makinerisë së minierave në minierat ekzistuese mund të rezultojnë në boshllëk gjatë dy viteve të ardhshme, duke e detyruar Kosovën të mbështetet në importin e shtrenjtë të energjisë.

Rezultatet kanë qenë të përziera sa i përket tregut të brendshëm të energjisë dhe implementimit të “Traktatit të komunitetit të energjisë”. Ligji për nxehjen qendrore është aprovuar në nëntor 2008 dhe përcakton kushtet për zhvillimin e tregut të qëndrueshëm dhe konkurrent për nxehjen rajonale, bazuar në parimet e tregut të lirë.

Janë përmbushur kërkesat e “Traktatit të komunitetit të energjisë” për ti ndarë llogaritë në mes të minierave, gjenerimit të energjisë, distribuimit të rrjetit dhe furnizimit; dhe të përgatiten për privatizim asetet e Korporatës Elektro-energjetike të Kosovës. Në korrik është përzgjedhur këshilltari i transaksionit për privatizim të komponentëve të distribuimit dhe furnizimit të korporatës, por kontrata ende nuk është nënshkruar. Kosova pret që privatizimi të përfundon deri në mes të vitit 2010. Në nëntor 2008, zyra e rregullatorit të energjisë ka aprovuar procedurën autorizuese për kapacitetet e reja gjeneruese siç kërkohet nga traktati. Nevojitet progresi i mëtejshëm për implementim. Kapacitetet institucionale dhe legjislative të ministrisë dhe rregullatorit vazhdojnë të jenë të dobëta. Tërheqja dhe mbajtja e stafit të kualifikuar vazhdon të jetë problematike.

Në verë, qeveria ka aprovuar strategjinë energjetike 2009-2018. Është e nevojshme që të aprovohet formalisht nga Kuvendi. Shtyllat kryesore janë financimi i sektorit, termocentrali “Kosova e re” dhe furnizimi me energji nga Korporata Elektro-energjetike e Kosovës. Strategjia po ashtu mbulon qeverisjen e mirë, mbrojtjen sociale dhe mjedisore, energjinë efikase / e ripërtërishme dhe gazin natyror.

Faturimi dhe inkasimi janë përmirësuar gjatë 12 muajve të kaluar, por është ende shumë ulët. Mospagimi i energjisë përfaqëson sfidë madhore për korporatën. Humbjet teknike dhe financiare vazhdojnë të janë të mëdha: prej energjisë që korporata mund të shes, mbi 20% është vjedhur ndërsa humbjet komerciale kanë qenë mbi 20%. Vetëm rreth 60% të energjisë së disponueshme për shitje është paguar. Korporata ka humbur rreth €90 milionë vitin e kaluar. Nevojiten përpjekje të fuqishme në mënyrë që të ngritët shkalla e faturimit dhe inkasimit të energjisë së prodhuar. Policia dhe gjyqësia kanë një rol të rëndësishëm në këtë. Si pasojë e mospagimit të faturave, konsumimi i energjisë elektrike vazhdon të ngritët në shkallë jo të qëndrueshme (rreth 8% në 2008), shumë më shumë së sa korporata mund të përballojë.

Në prill, rregullatori ka aprovuar tarifën e reja të transmissiionit dhe shitjes me pakicë të energjisë elektrike. Ato janë mesatarisht 2.5% më të larta së në vitin 2008, sipas ngritjes vjetore të udhëhequr nga metodologjia e tarifave të zyrës së rregullatorit të energjisë, e cila gradualisht paraqet tarifën që reflektojnë koston. Konsumatorët me të ardhura më të vogla përfitojnë më shumë nga tarifën më të ulët. Operatori kosovar i transmissiionit të sistemit elektrik (KOSTT) vazhdon të ballafaqohet me vështirësi si partner i barabartë në mekanizmat komercial rajonal: mekanizmi i kompensimit ndër-transmetues dhe mekanizmat e alokimit të kapaciteteve. Operatori serb (më tepër së KOSTT) kompensohet për transitiin energjetik përmes rrjetit elektrik të Kosovës dhe vazhdon të alokojë kapacitetet ndërlihdhëse të transmissiionit të KOSTT-it. Humbjet e shfaqura si pasojë kalohen tek konsumatorët.

Plani kosovar i efikasitetit të energjisë, i aprovuar në shkurt 2009, parasheh caqet ambicioze për ngritjen e efikasitetit për 3% deri në 2011 dhe për 9% deri në 2016 krahasuar me nivelin e konsumit të vitit 2008 për familje, shërbimet, transport, industri dhe bujqësi. Do të nevojiten masat e shtuara ligjore dhe administrative për ti përmbushur këto caqe, veçanërisht sa i përket sektorit të familjes, ku 34% të energjisë konsumohet. Sa i përket energjisë së ripërtërishme, rregullatori ka pranuar shtatë kërkesat për ndërtim të turbinave të erës. Qeveria ka identifikuar 16 lokacione të cilat mund të kualifikohen për kapacitetet e reja hidro-gjeneruese të cilat parashihet që mund të gjenerojnë deri 60 megavat. Rregullatori ka aprovuar feed-in tarifën konkurruese për energjinë e gjeneruar nga burimet ripërtërishme, me qëllim të tërheqjes së investimeve në këtë sektor.

Ka progres minimal në fushën e sigurisë nukleare dhe mbrojtjes nga rrezatimi. Vlerësimet preliminare janë duke u bërë për të implementuar rregullat në menaxhimin dhe monitorimin të burimeve radioaktive dhe mjekësore, si dhe mbeturinave industriale radioaktive. Nuk ka kornizë ligjore në këtë fushë dhe nuk ka autoritet të sigurisë

nukleare. Nuk është bërë progres në parandalimin dhe luftimin e trafikimit të kundër ligjshëm të materialeve nukleare dhe materialeve tjera radioaktive.

Në përgjithësi, ka pasur progres të kufizuar në fushën e energjisë, megjithëse përafrimi ligjor ka pasur vonesa. Megjithatë, problemet madhore mbesin për tu adresuar, të cilët përfshijnë përmirësimin e gjendjes financiare të Korporatës Elektro-energetike të Kosovës (duke i zvogëluar humbjet komerciale dhe jo-teknike), menaxhimin e kërkesës, modernizimi i infrastrukturës dhe zgjidhja e mungesës së mundshme të linjtit të Kosovës.

4.2.6 Shoqëria informative dhe mediet

Janë bërë disa progres në fushën e komunikimeve elektronike. Agjensioni Rregullativ i Telekomunikimit është pajisur me pajisje spektër-monitorim që mundëson identifikimin e aktiviteteve ilegale në Kosovën veriore dhe në hapësirat kufitare me shtetet fqinje. Depërtimi i shitjes së telefonave mobile është rreth 60%, depërtimi i internetit rreth 5.4%. Licenca e trete për telefoni fikse është lëshuar në Janar 2009 por ende nuk është bërë operuese. Dy operator të rrjetit mobil virtual janë licencuar, njëra është aktive në treg. Implementimi i politikës të sektorit e adoptuar me 2007 është duke ndjerë vonesa.

Gjithashtu në Shtator, asambleja ka aprovuar një bord të ri të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikimit, 9 muaj pasi që i ka kaluar mandati bordit të mëparshëm. Meqë Agjensioni ka fuqi legjislative, bordi është dashtë të lëvizë në shpejtësi me miratimin e implementimit të legjislacionit vendimtar për funksionim të duhur të tregut dhe sigurimin e zbatimit të tij. Kapaciteti e të dyjave: Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Agjensionit Rregullativ të Telekomunikimit është i limituar për performace efektive të detyrave të saja në këtë fushe. Operimi, pavarësia politike dhe financiare e Agjensionit duhet të jene të përforcuara. Kosova nuk posedon kod internacional dhe "domain name" për internet të nivelit të lartë. Kjo gjithashtu vonon implementimin e disa mbrojtjeve konkurruese siç është transportueshmëria e numrit.

Është bëra progres i limituar në fushën e shërbimeve për informim shoqëror. Ligji 2005 në shërbimin e informimit shoqëror ka zhvendos shumicën e masave të direktivave në e-commerce, e-signatures, mbrojtjen e të dhënave dhe e-privacy, por implementimi është bërë i kufizuar. Ligji për krim përmes internetit ende nuk është miratuar. Mbi të gjitha shërbimi për informim të shoqërisë ka nevojë të jetë me tepër e zhvilluar. Strategjitë relevante dhe planet për aksion janë ende për implementim të plote.

Është bërë ca progres në fushën e politikës dhe mediave audivizuale. Ligji që mbulon industrinë e medieve – ligji për Komisionin e Pavarur për Media dhe Ligji për Transmetim Publik janë në korrigjim e sipër. Ri-licencimi I transmetuesve ka filluar: në fund të gushtit, grupi I pare I licencave afatgjate është aprovuar për ekzistim si transmetues. Komisioni I Pavarur për Media është duke taksuar aplikacionet për frekuencat e reja. Operatorët kabllovikë në veri nuk janë licencuar nga Komisioni.

Pavarësia e komisionit, në veçanti lidhur me stafin dhe resurset ka nevojë të garantohet në kontekstin e amendamentit të mundshëm legjislativ. Takimi i natave të këshillit të Komisionit nga Asambleja dhe bordi i RTK-së është ende duke u kompletuar.

Në maj, rregullacioni për transmetues lidhur me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve nga programet me përmbajtje seksuale është shtrënguar, por nuk ka ndonjë mekanizëm për të implementuar dhe detyroj atë. Asnjë zhvillim nuk mund të raportohet në ndryshmin nga transmetimi analog në digjital. Kosova nuk është anëtare e Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikimit dhe ka vetëm një ndarje të frekuencës. Kjo nuk jep hapësirë për frekuenca digjitale që siguron një sinjal televiziv tokësore pas 2015-së.

Qëndrueshmëria financiare e transmetuesit publik nuk është e sigurt. Kontrata me të çilen tarifa e licencës është mbledhur përmes faturave të rrymës do të skadojë në Nëntor. Ligji i RTK-së parasheh tenderë vjetorë për të blere pune audiovizuale nga producent të pavarur, të çilet do të llogaritin 20% e programeve të prodhuara. Kjo nuk është kompletuar plotësisht. Ligjet që nuk janë në përputhje me Ligjin mbi Shpifje dhe Ofendim dhe Kodit Penal ende nuk janë zgjidhur. Sipas standardeve evropiane shpifja nuk do të jetë kundërvajtje kriminale. Kosova nuk aplikon dispozita penale për shpifjen, por me që ato janë në ligje, pasiguria ligjore vazhdon.

Pas dy viteve mungese Fondi i Medieve për Pakica ka filluar serish të funksionoj nga janari. 14 media kane pranuar dhurata këtë vit. Janë 110 transmetues të licencuar, 41 media reprezentuese për minoritete (32 serbe, 3 turke, 3 boshnjake, 2 gorane dhe 1 rome). Nuk ka ndonjë kanal të pavarur për minoritete që mbulon tere Kosovën. IMC Rregullacioni në Komunikimet Audiovizuale ishte miratuar në fund të Gushtit. Kjo do të ketë efekt të pjesshëm në RTK duke imponuar kufizime mbi pragjet e reklamimeve.

Zhvillime pozitive mund të raportohen si lidhjet mes Shoqata e Transmetuesve Medial të Pavarur të Kosovës dhe mediet për minoritete nga veriu. Ligji mbi qasje të informimit ende nuk është implementuar plotësisht, në të çilen pengon punën e gazetareve. Këshilli për Shtyp është trup vet-rregullues që varet nga donacionet për financimet e tyre. Zbatimi i tyre është i dobët.

Megjithatë, është bërë progres në fushën e shoqërisë informative dhe media. Megjithatë ka shume pune për tu bërë. Implementimi i ligjit për RTK-n dhe emërimi I bordit të ri mbetet problemi me serioz për tu shqetësuar, siç nevojitet forcimi I kapacitetit administrative, pavarësia financiare dhe politike e të dy autoriteteve rregullatorë, gjithashtu kapaciteti human I Komisionit të Pavarur për Media.

4.2.7. Kontrolli financiar

Ka pasur një përparim të kufizuar Kontrollin Financiar të Brendshëm Publik (PIFC). Përpjekjet janë fokusuar kryesisht në zhvillimin e kapacitete të auditorit të brendshëm dhe më pak në menaxhmentin financiar dhe kontrollin e sistemeve. Ligji mbi Auditorin e brendshëm është adaptuar në Shtator. Eshë zhvilluar një manual për auditim dhe trajnim i auditorëve ka vazhduar. Auditor i brendshëm koncentrohet kryesisht në testin për

vetëkënaqësi por akoma nuk shihet si mjet menaxherial. Qeveria ka aprovuar strategjinë zhvillimore për auditorin e brendshëm 2010-2012.

Sa i përket auditorit të jashtëm, Zyra për Auditorin Gjeneral ka përgatitur disa dokumente në muajt e parë të vitit 2009, duke përfshirë manualin e auditorit të jashtëm, direktivën e re për auditorin, kornizën kualitative, kodin e amandamentuar të sjelljes formatin standard të raportimit. Standardet kryesore ndërkombëtare janë përkthyer (siç janë INTOSAI Udhëheqje on Këshilli i brendshëm dhe kodi i mirësjelljes). Dy raportet e para të Auditorit Gjeneral iu janë dërguar Parlamentit në vitin 2008 dhe 2009 respektivisht. Sistemet adekuate përcjellëse mbi auditorin e jashtëm dhe rekomandimet kanë mangësi. Pavarësia financiare e Zyrës është e pamjaftueshme.

Në përgjithësi ka pasur një përparim modest në këtë fushë. Zhvillimet në kontrollin publik të brendshëm dhe auditorit të jashtëm janë në fazën fillestare. Nevojiten përpjekje të vazhdueshme në veçanti për të përmirësuar menaxhimin financiar dhe kontrollin mjedisor.

4.2.8. Statistikat

Ka pasur një progres në fushën e statistikave. Në Gusht, Zyra për Statistikë e Kosovës ka adaptuar planin për zhvillimin strategjikë për vitet 2009-2013. Fushat me prioritet përfshijnë strukturën statistikore, kualitetin e të dhënave për studime (survey data quality), zhvillimi i IT-ve dhe trajnimi i stafit. Fokusi kryesor është akoma në statistikatat sociale dhe demografike sesa në ato ekonomike. Sistemi i IT-ve është përmirësuar dhe një memorandum mirëkuptimi është nënshkruar me furnizuesit e të dhënave, gjë që ka përmirësuar e sistemeve statistikore, por akoma ka vend për përmirësim sa i përket bashkëveprimet në mes të hartuesve të ndryshëm të të dhënave statistikore. Ligji mbi Statistikat Zyrtare nuk është aprovuar akoma.

Infrastruktura Statistikore e Kosovës mbetet e varfër. Kapaciteti i dobët dhe pavarësia joadekuate e zyrës statistikore janë akoma për brengosje. Disa ministri bëjnë mbledhjen e të dhënave statistikore që bëhen nga zyra statistikore.

Ka pasur një progres të kufizuar fushën e klasifikimeve dhe regjistrave. Klasifikimi i njësive institucionale dhe ai i transaksioneve ekonomike është përmirësuar. Mirëpo, ka nevojë për zhvillim të mëtutjeshëm në përshtatjen me standardet e BE-së. Zyra Statistikore e Kosovës akoma nuk e ka paraqitur NACE Rev 2. dhe duke përdorur akoma standardin NACE Rev 1. Regjistri biznesor është funksional por lidhjet dhe mbulimi i tyre është joadekuat për statistika të besueshme ekonomike.

Sa i përket sektit statistikor, ka pasur një progres në fushën ekonomike, biznese dhe në statistikatat bujqësore. Pilot studimet janë mbajtur për indeksin e çmimit të prodhuesit, statistikatat biznese dhe ato sociale. Gjetjet janë përdorur në hartimin e llogarive kombëtare (national accounts). Mirëpo, llogarit kombëtare mbeten të pamjaftueshme dhe kanë nevojë për përmirësim të mëtutjeshëm.

Një test fillestar për regjistrimin e popullsisë është mbajtur në gjashtë komuna të Kosovës në Nëntor të vitit 2008. Kjo tregon një përmirësim në kapacitetet e Zyrës Statistike të Kosovës për të bërë regjistrimin e popullsisë. Mirëpo rekomandimet e Sistemit Ndërkombëtar të Mbikëqyrjes së Veprimeve nuk janë implementuar plotësisht. Në veçanti bojkoti i komunitetit Serb nuk është analizuar si duhet. Zyra Statistike nuk ka strategji për të iu qasur kësaj çështje. Në Qershor, Qeveria ka shpallur qëndrimin e saj rreth organizimit të përgjithshëm të regjistrimit të popullsisë në vitin 2011.

Në përgjithësi, mund të raportohet për progres të arritur në fushën e statistikave sektoriale, mirëpo Zyra e Statistikave të Kosovës akoma nuk është në gjendje për të prodhuar statistika ekonomike të mjaftueshme për të përforcuar politik-bërjen efektive. Kjo zyre nuk ka kapacitet të mjaftueshëm administrative për të bërë studime të mëdha.

4.3. Drejtësia, Liria dhe Siguria

4.3.1. Vizat, menaxhimi i kufirit, azili dhe migracioni

Siguria e dokumenteve të udhëtimit është përmirësuar me fillimin e lëshimit të pasaportave të reja të Kosovës në vitin 2008. të gjitha vendet që i njohin këto pasaporta lëshojnë viza në to. Ligji për të huajt është miratuar në dhjetor 2008. Aktet relevante nënligjore nuk janë miratuar ende. Janë miratuar një pjesë e madhe e legjislacionit që plotëson kornizën ligjore në lidhje me lëshimin e kartelave të identifikimit, pasaportat, nënshtetësinë.

Prodhimi i dokumenteve ende mbetet një çështje, që komplikon kontrollin ndaj migracionit dhe luftës kundër krimit. Siguria dhe kontrolli i lëshimit të dokumenteve është shqetësuese, siç është edhe siguria e regjistrave dhe bazave të të dhënave përkatëse. Strukturat paralele serbe në Kosovë paraqesin një sfidë të veçantë në këtë aspekt.

Është bërë progres i kufizuar sa i përket kufirit dhe vijës kufitare. Në prill të vitit 2009 është miratuar strategjia e rishikuar për menaxhimin e integruar të kufirit dhe plani i veprimit, për koordinimin e aktiviteteve të agjencive të përfshira në kontrollin e dhe menaxhimin e kufirit. Bordi ekzekutiv për menaxhimin e integruar të kufirit është formuar në maj 2009, i përbërë nga koordinatori për menaxhimin e integruar të kufirit dhe përfaqësuese të organeve përkatëse. Shtrirja e misionit të BE-së për sundimin e Ligjit EULEX në dy pikat kufitare (porta 1 dhe 31) ndërmjet Kosovës dhe Serbisë kanë pasur një ndikim pozitiv. Policia e Kosovës ka filluar procesin e ristrukturimit përfshirë edhe departamentet përkatëse për kufirin.

Megjithatë, kufijtë e Kosovës janë të brishtë dhe ende jo shumë të sigurt. Veriu paraqet një sfidë të veçantë. Mungesa e funksionimit të plotë të doganave më këtë pjesë pengon luftimin efikas kundër krimit të organizuar. Bashkëpunimi ndërmjet organeve të përfshira në menaxhimin e kufirit është i pamjaftueshëm. Kosova duhet të sigurohet së sistemi i TI-së për kontrollimin e kufirit dhe monitorimi të jetë në përputhje me standardet e BE-së.

Në përgjithësi, Kosova vetëm sa ka filluar të adresojë çështjen e politikës së vizave dhe menaxhimit të kufirit dhe vijës kufitare. Kosova duhet të zhvillojë një politikë koherente të vizave në pajtim me standardet e BE-së.

Është shënuar progres i kufizuar në fushën e azilit. Kosova ka miratuar një pjesë të legjislacionit zbatues për trajtimin e azilkërkuesve. Në qershor 2009, është vënë në funksion një bazë e të dhënave për azilkërkuesit. Megjithatë, duhet të adresohen një numër i sfidave. Kapacitetet e Departamentit për Nënshitetësi, Azil dhe Migracion si dhe të policisë përgjegjës për azilkërkuesit dhe aplikimit për azil janë të mangëta. Nuk është formuar organi për ankesa për rastet e azilit. Një qendër pranuese për akomodimin e azilkërkuesve pritet të ndërtohet dhe Kosova ende ka mungesë të qendrave të paraburgimit për emigrant të huaj. Në përgjithësi, përgatitjet në këtë fushë janë në fazën fillestare.

Ka progres të pjesërishtëm në fushën e migracionit. Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjëse për kërkesat e riatdhesimit nga vendet e treta. Vendet të cilat nuk e kanë njohur Kosovën vazhdojnë të drejtojnë kërkesat e tyre UNMIK-ut. Departamenti për Nënshitetësi, Azil dhe Migracion ka pranuar 2,878 kërkesa për riatdhesim ndërmjet tetorit dhe korrikut; 2,577 persona janë riatdhesuar nga Kosova nga vendet e treta. Bashkëpunimi ndërmjet organeve përkatëse brenda administratës së Kosovës që kanë përgjegjësi në këtë proces është i kënaqshëm. Në korrik Kosova ka miratuar ligjin për dhënien e leje të punë për të huajt si dhe legjislacioni për lëshimin e kartelave të identifikimit për të huajt. Në shtator, Kosova ka miratuar strategjinë dhe planin e veprimit për migracion.

Megjithatë, strategjia dhe plani i veprimit nuk adreson mjaftueshëm çështje të rëndësishme sikur kontrollet e daljes, kontrollet e dokumenteve të falsifikuara, etj. Edhe pse ligji për të huajt është miratuar, pritet të fuqizohet legjislacionit sekondar përkatës. Nuk janë lëshuar ende dispozitat zbatuese të këtij ligjit përveç një udhëzimi administrativ për kartela të identifikimit për të huajt, e cila duhet të përmirësohet. Kthimi mbetet i paqëndrueshëm, sikurse pasi që strategjia për ri-integrimin e personave të riatdhesuar nuk është zbatuar në mënyrë të duhur. Bordi koordinues ndërministror me anë të strategjisë për ri-integrimin e personave të riatdhesuar është takuar vetëm një herë. Nuk ka ndonjë organ për mbikëqyrje të politikës së Kosovës për ri-integrim. Ri-integrimi i personave të kthyer mbetet një mangësi e madhe. Gjithashtu, menaxhimi i procesit të riatdhesimit dhe procesi i verifikimit të personave që vijnë nga Kosova duhet të përmirësohet, posaçërisht sa i përket personelit, kapaciteteve teknike, dokumentacionit dhe statistikave. Nuk ka ligj për riatdhesimin.

Në përgjithësi, Kosova ka filluar të adresojë prioritetet e saj në fushën e migracionit. Megjithatë, duhet të plotësohet korniza legjislative dhe të sigurohet cilësia e dokumenteve të miratuar. Kapacitetet për ri-integrimin e të kthyerve janë një pengesë e madhe për zbatimin e plotë të politikave në këtë fushë.

4.3.2. Shpëlarja e parave

Trajtimi i krimit financiar është një prioritet kyç i Partneritetit Evropian. Megjithatë, Kosova ka ndërmarrë vetëm disa hapa të vogël për të adresuar këtë fenomen në mënyrë efektive. Një rregullore e UNMIK-ut vazhdon të rregullojë aktivitetet qeveritare dhe të agjencive të tjera në këtë fushë. Bankat, doganat, zyrat për shkëmbim dhe ndërmjetësues tjerë financiar duhet të raportojnë parat e gatshme ose transferet elektronike në Qendrën për Inteligjencë Financiare të menaxhuar nga EULEX. Kjo qendër vepron si njësi kombëtare e inteligjencës financiare. Ka filluar zbatimin e një sistemi të ri të raportimit, që pritet të ofrojë përmirësime të rëndësishme. Qendra gjithashtu ka vendosur raporte me institucione relevante në Shqipërinë, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Malin e Zi dhe me disa anëtarë të grupit Egmont.

Në korrik është miratuar Ligji për Menaxhimin e Aseteve të sekuestruara dhe konfiskuara. Megjithatë, korniza legjislative duhet të fuqizohet për të siguruar se shpëlarja e parave është definuar si krim, se njësia e ardhshme për inteligjencë financiare është pavarur nga ndikimi politik dhe ndikime të tjera, dhe se aktet nënligjore përkatëse janë në pajtim me standardet evropiane.

Mbikëqyrja e sektorit privat dhe në veçanti sektori i patundshmërisë duhet të adresohet në mënyrë urgjente. Bashkëpunimi ndërmjet qendrës dhe administratës tatimore është i mangët. Raportimi nga institucionet jo bankare në qendër është i pamjaftueshëm. Kapaciteti i autoriteteve gjyqësore dhe agjencive për zbatimin e ligjit kanë vështirësi për të detektuar me kohë shkeljet në këta sektor. Agjencia për Menaxhimin e Aseteve të Sekuestruara dhe Konfiskuara si institucion i vetëm për menaxhimin e këtyre asetëve nuk është ende funksionale.

Në përgjithësi, shpëlarja e parave mbetet një breng e madhe. Kosova ka mangësi të dispozitave adekuate legjislative dhe struktura funksionale për të luftuar këtë fenomen.

4.3.3. Narkotikët

Është bërë pak progres në luftën kundër trafikimit të narkotikëve. Kosova gjendet në pjesën jugore të vijës së trafikimit të narkotikëve. Policia e Kosovës ka ndërmarrë një numër të operacioneve efektive në luftën kundër abuzimit dhe trafikimit të narkotikëve. Sasia e narkotikëve të konfiskuar dhe numri i rasteve dhe personave të arrestuar dhe ndjekur është rritur. Në qershor Kosova ka miratuar strategjinë dhe planin e veprimit kundër narkotikëve me qëllim të uljes së furnizimit dhe kërkesave në vijë me një plan të veprimit. Njësia për bashkëpunim ndërkombëtar policor e ndërlidhur me shërbimet policore në vendet si Zvicra, Gjermania dhe Italia.

Megjithatë, përderisa në strukturim e sipër, policia ka mangësi të buxhetit adekuat dhe një organ efektiv për të luftuar narkotikët ilegal. Kosova gjithashtu nuk ka numër të mjaftueshëm të qenve të trajnuar për detektimin e narkotikëve dhe njësinë për trajnimin e qenve. Seksioni qendror për hetimin e narkotikëve ka nevojë për më tepër mbështetje. Bashkëpunimi ndërmjet agjencive për zbatimin e ligjit është ende shumë i dobët dhe

qarkullimi i informacioneve nuk është i integruar. Ruajtja e duhur e narkotikëve nuk është e siguruar në mënyrë adekuate në Kosovë.

Në përgjithësi, luftimi i trafikimit të narkotikëve në Kosovë është në fazën fillestare të zhvillimit. Qëndrojnë mangësi të shumta në aspektin e kapaciteteve të policisë për të trajtuar trafikimin në mënyrë efikase dhe niveli i pamjaftueshëm i bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informatave ndërmjet institucioneve përkatëse.

4.3.4. Policia

Kosova ka bërë progres të pjesërishëm sa i përket fushës së policisë. Është vendosur korniza bazike legjislative. Policia e Kosovës ka menaxhuar shumë mirë funksionet e mbajtjes së rendit publik. Policia ka vazhduar në zbatimin e planit të saj strategjik 2008-2010. policia gjithashtu ka ngritur infrastrukturën e komunikimit. Ministria e Punëve të Brendshme ka formuar këshillat komunale për sigurinë e komuniteteve për fuqizuar raportet ndërmjet policisë, autoriteteve komunale dhe komuniteteve lokale. Shumica e zyrtarëve të policisë nga ana e komunitetit serb të Kosovës në jug të lumit Ibër, që kanë lënë shërbimin pas deklarimit të pavarësisë, u janë kthyer punës në stacionet e tyre. Në shtator, Kosova ka miratuar Ligjin mbi armët. Ligji është në harmoni me legjislacionin përkatës të BE-së dhe përfshinë dispozitat e duhura ndëshkuese. Në janar të vitit 2009, Ministria e punëve të brendshme ka një numër të udhëzimeve administrative lidhur me armët e vogla.

Megjithatë, një numër i incidenteve të dhunshme, përfshirë edhe dëmtimin e pronës së EULEX-it kanë ndodhur në Kosovë. Posedimi i madh i armëve nga popullata mbetet një problem serioz. Nuk ka strategji për grumbullimin e armëve të tilla. Ligji për eksplozivët duhet të rishikohet dhe të freskohet si dhe të miratohet legjislacioni përkatës për zbatimin e tij. Kosova nuk ka ende ligj për mjekësi ligjore dhe autopsi. Duhet të përmirësohet bashkëpunimi ndërmjet policisë dhe zyrës së prokurorit. Policia ende ka mungesë të kapaciteteve për zhvilluar planifikimin strategjik dhe të zbatojë plotësisht sistemin policor të inteligjencës. Policia ende nuk i ka hartuar përkrahjet e vendeve të punës për stafin e lartë menaxhues, përfshirë dy Zëvendës Drejtorët e Përgjithshëm. Kryeshefi Ekzekutiv i Inspektoratit të Policisë duhet të emërohet dhe të sigurohen funksione profesionale dhe të pavarura ekzekutive të inspektoratit. Riorganizimi i forcës policore nuk është përfunduar ende dhe kërkon përgatitje adekuate.

Hapësirat për ruajtjen e evidencave nuk janë plotësisht të mbrojtura. Në prill, në masë e konsiderueshme e heroinës është vjedhur nga dhoma e evidencave. Rrjetet e komunikimit policor nuk janë plotësisht të integruara dhe të mbrojtura. Kanalet e komunikimit me agjencionet tjera për zbatim të ligjit nuk janë ende funksionale. Jo të gjitha stacionet lokale të policisë me sistemin kryesor të policisë. Raportet e dërguar nga stacionet lokale të policisë përmes intranetit nuk janë gjithmonë të sigurta. Sistemi i informimit të policisë duhet të modernizohet me qëllim të evitimit të duplikimit të krimeve dhe personave të regjistruar. Statistikat rreth krimit nuk bazohen në procedurat standarde operative për statistika dhe regjistrime. Të dhënat në dispozicion nuk përdoren çdoherë efektivisht në udhëheqjen e përcaktuar së punës së policisë. Përpjekjet e Kosovës në lidhjen e bazave të

të dhënave për zbatim të ligjit duhet të marrin parasysh standardet evropiane relevante, veçanërisht sa i përket mbrojtjes së të dhënave. Ministria e Punëve të Brendshme duhet të përparojë me përpjekjet lidhur me lejimin e qasjes së EULEX-it në bazat kyçe të të dhënave në mënyrë që të mundësohen hetimet efektive nën mandatin ekzekutiv të misionit. Bashkëpunimi i policisë ndërkombëtare është i kufizuar. EULEX-i duhet të luajë rol të rëndësishëm në lehtësimin e kësaj qasjeje.

Në janar, policia krijoi në njësi të përzier në Mitrovicën veriore, më përbërje të 25 zyrtarëve të policisë (serbë, shqiptarë dhe boshnjakë të Kosovës). Policia ka mandat patrullues dhe hetues. Aktivitetet e njësisë kanë rezultuar me reduktimin e krimit në zonat e mbuluar. Në Mitrovicën veriore, katër stacione policore nuk i raportojnë drejtpërdrejt Prishtinës, që kufizon efektivitetin e luftimit të krimit të organizuar dhe ndërmarrjen e operacioneve sekrete në këtë zonë. Sidoqoftë, kjo është adresuar dhe me caktimin e zyrtarëve të lartë policorë të komunitetit serb në strukturat rajonale komanduese në Mitrovicë bashkëpunimi është përmirësuar. Në qershor, shumica e zyrtarëve policorë të komunitetit serb poshtë lumit Ibër, të cilët kanë lëshuar shërbimin pas shpalljes së pavarësisë, janë kthyer në stacionet e tyre dhe në punë dhe punojnë nën zinxhirin e zakonshëm komandues.

Në përgjithësi, Kosova ka iniciuar proceset rreth adresimit të prioriteteve në këtë fushë. Përshkrimet e punës për menaxhmentin e lartë duhet të finalizohen urgjentisht dhe stafi përkatës të rekrutohet. Kapacitetet hetuese duhet të përforcohen dhe policia e inteligjencës të prezantohen dhe të zbatohet dhe mbrojtja e evidencave të adresohet. EULEX-it duhet t'i lejojehet qasje në të gjitha bazat e të dhënave relevante.

4.3.5. Luftimi i krimit të organizuar dhe terrorizmit

Ka pasur progres të kufizuar në adresimin e krimit të organizuar, që mbetet një çështje serioze, veçanërisht në veri të Kosovës dhe vijat kufitare në mes Kosovës dhe Serbisë. Në korrik, Kosova miratoi strategjinë dhe planin e veprimit për ndaluar krimin, Ligji për Ruajtjen e Qetësisë dhe Rendit Publik është miratuar në shtator. Në qershor, Zyra e Prokurorit ka nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi me Drejtorinë Kombëtare Italiane Anti-Mafia rreth shkëmbimit të informatave për luftimin e krimit të organizuar, por ende duhet formalisht të miratohet.

Sidoqoftë, Kosova nuk e ka strategjinë për reduktimin e krimit. Kosovës i mungojnë burimet e përshtatshme dhe një sistem i përshtatshëm i inteligjencës kriminale për të ndaluar këtë dukuri. Mungesa e ligjit dhe programit për mbrojtjen e dëshmitarëve ende pengon përpjekjet në këtë fushë. EULEX-i luan rol të rëndësishëm përmes hetimit të veprave serioze kriminale dhe duke siguruar mbrojtje dëshmitarëve.

Në përgjithësi, Kosova duhet në masë të konsiderueshme të rrisë përpjekjet e saj. Kosova mbetet burim dhe vende transit për aktivitetet e krimit të organizuar. Mungesa e bashkëpunimit në mes të Prishtinës dhe Beogradit si dhe në mes të autoriteteve qendrore kosovare dhe strukturave në veri seriozisht pengon përpjekjet për luftimin e krimit të organizuar, që është prioritet kyç në kuadër të Partneritetit Evropian.

Kosova ka arritur progres të kufizuar në pengimin e trafikimit me qenie njerëzore. Procedurat standarde të operimit janë shqyrtuar në nëntor 2008 për të përfshirë të gjithë viktimat e trafikimit dhe për të konsoliduar sistemin për identifikimin dhe mbrojtjen e viktimave. Implementimi i plotë i tyre pritet arrihet së shpejti.

Numri i viktimave të trafikimit të identifikuar mbetet i ulët. Divizioni për mbrojtje dhe ndihmë viktimave vazhdon të veprojë brenda Ministrisë së Drejtësisë, duke siguruar gjithashtu ndihmë viktimave të trafikimit. Zëvendësministri i Punëve të Brendshme është koordinator kombëtar kundër trafikimit. Kosova vazhdon të mbetet burimi, destinimi dhe rruga transit për personat e trafikuar. Shumica e viktimave trafikohen përbrenda Kosovës (rreth 60%). Viktimat gjithashtu janë nga Moldavia (20%) dhe vendet e Ballkanit Perëndimor (20%). Trafikimi i fëmijëve me qëllim të lypjes së detyruar është një problem në rritje. Në përgjithësi, përpjekjet e Kosovës për të luftuar kundër trafikimit me qenie njerëzore nuk janë aq të avancuara. Trafikimi lidhur me korrupsionin duhet të adresohet. Hetimi dhe ndjekja e krimeve të trafikimit nga autoritetet kosovare mbeten shqetësim.

Është arritur progres në luftimin e terrorizmit. Strategjia dhe plani i veprimit për luftimin e terrorizmit janë miratuar në Qershor. Sidoqoftë, Kosova nuk ka ligj kundër terrorizmit.

Në përgjithësi, Kosova është në fazë të hershme të trajtimit të terrorizmit.

4.3.6. Mbrojtja e të dhënave personale

Kosova ende duhet të harmonizojë legjislacionin e saj me standardet e BE-së rreth mbrojtjes së të dhënave, në veçanti me direktivën 95/46/EC. Ligji i përgjithshëm për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të miratohet dhe një autoritet i pavarur mbikëqyrës mbetet të themelohet.

Personat në Kosovë nuk janë të informuar rreth të drejtave të tyre lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale. Themelimi i organeve sigurisë, inteligjencës dhe zbatimit të ligjit dhe bazave të tyre të të dhënave nuk janë shoqëruar me masat paralele për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në përgjithësi, Kosova ende duhet të ndërmarrë dhe të përfundojë me përpjekjet gjithëpërfshirëse në këtë fushë. Mangësitë momentale janë çështje brengosëse.